FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 118

Tiranë – E enjte, 9 korrik 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 583, datë 1.7.2015	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për aparatin e Kryeministrisë.....	6191
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 1.7.2015	Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e sigurisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë.....	6191
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 585, datë 1.7.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 439, datë 13.5.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e dokumentit "Politikat dhe procedurat e funksionimit të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD)"".....	6196
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 587, datë 1.7.2015	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Prokurorinë e Përgjithshme.....	6208
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 588, datë 1.7.2015	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Agjencia e Trajtimit të Kredive te Ministria e Financave, për degën e thesarit Gjirokastër, të një ambienti në pronën nr. 4/183+1-12, në zonën kadastrale nr.8542, me vendndodhje në adresën "Lagjja Varosh", në qytetin e Gjirokastrës, dhe për një ndryshim në vendimin nr.513, datë 15.8.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Financave për Agjencinë e Trajtimit të Kredive".....	6209
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 1.7.2015	Për një shtesë në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar.....	6216

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 590, datë 1.7.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 41, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për një ndryshim në vendimin nr. 378, datë 12.8.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin e së drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte, pronë publike, organeve të qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe një ndryshim në vendimin nr. 127, datë 2.2.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Maliq, të qarkut të Korçës".....	6216
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 592, datë 1.7.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 283, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore".....	6219
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 593, datë 1.7.2015	Për rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve të miratuara në buxhetin e vitit 2015, për Ministrinë e Kulturës.....	6219
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 594, datë 1.7.2015	Për miratimin e listës së sëmundjeve profesionale.....	6219
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 595, datë 1.7.2015	Për miratimin e ndryshimit të statusit nga tokë bujqësore në tokë truall dhe vënien në dispozicion të pasurive për ndërtimin e shtëpive dhe infrastrukturës së nevojshme për sistemimin e personave të prekur nga ndërtimi i Hec-it të Banjës.....	6222
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 1.7.2015	Për përcaktimin e procedurave dhe kërkesave të hollësishme për lidhjen e marrëveshjeve vullnetare, ndërmjet organizatave dhe grupeve që përfaqësojnë interesa të caktuara, grupeve të operatorëve ose operatorëve individualë me autoritetet përkatëse, për realizimin e një niveli më të lartë mbrojtjeje, sesa ai i përcaktuar në legjislacionin e posaçëm, për një përbërës mjedisor.....	6224
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 598, datë 1.7.2015	Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar.....	6225
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 599, datë 1.7.2015	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 54, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i objektit "Studim, projektim, lidhja e rrugës transballkanike me superstradën Fier-Vlorë", të ndryshuar.....	6231
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 600, datë 1.7.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 27, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kV Ersekë-Përmet".....	6235

VENDIM
Nr. 583, datë 1.7.2015

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR APARATIN E KRYEMINISTRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aparatit të Kryeministrisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, t'i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për bashkëfinancimin e efekteve financiare të vitit 2015 të planit të veprimit të projektit "STAR", sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur nga ministri i Shtetit për Çështjet Vendore dhe Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP).

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2015.

3. Ngarkohen Kryeministria dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 584, datë 1.7.2015

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E SIGURISË, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e sigurisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE
PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E SIGURISË NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Këshill i i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Turqisë dhe më poshtë të referuara si "Palë",

brenda kuadrit të marrëdhënieve miqësore që ekzistojnë ndërmjet dy vendeve;

të shqetësuar për rritjen botërore të akteve terroriste në nivel ndërkombëtar dhe krimin ndërkombëtar, krimet e lidhura me lëndët narkotike dhe trafikimin e paligjshëm të tyre;

duke vepruar sipas parimit të barazisë dhe Të interesit reciprok, në përputhje me ligjet e brendshme, rregullat dhe procedurat e shteteve të tyre dhe në përputhje me dispozitat e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të zbatueshme, pa cenuar interesat e ndonjë pale të tretë;

duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit parashikuar brenda kuadrit të "Protokollit të bashkëpunimit në fushën e sigurisë së rendit publik ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë", nënshkruar në Tiranë, më 1 qershor 1992,

kanë renë dakord si vijon:

Neni 1
Fushat e bashkëpunimit

1. Palët, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe nëpërmjet autoriteteve të tyre kompetente angazhohen të bashkëpunojnë në fushën e parandalimit të kërcënimeve ndaj rendit dhe sigurisë publike, të japin ndihmë të ndërsjellë në parandalimin dhe zbulimin e krimeve, dhe në kërkimin e personave që kanë kryer krime. Këto

fusha bashkëpunimi, siç përcaktohen në legjislacionet e tyre kombëtare janë si më poshtë:

a) Vepra penale kundër jetës, shëndetit, lirisë, dinjitetit njerëzor dhe pronës;

b) Krimi i organizuar;

c) Terrorizmi dhe financimi i terrorizmit;

d) Prodhimi i paligjshëm dhe trafikimi i lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve të tyre;

e) Ulja e kërkesës për përdorimin e drogës;

f) Korrupsioni, veprat penale që lidhen me aktivitetet financiare dhe ekonomike;

g) Migracioni i paligjshëm dhe trafikimi i qenieve njerëzore;

h) Tregtimi dhe trafikimi i qelizave, indeve dhe organeve të njeriut;

i) Prodhimi, tregtimi i paligjshëm dhe kontrabanda e armëve, municioneve, eksplozivëve, materialeve bërthamore, radioaktive, kimike dhe biologjike, si edhe materialeve të tjera të rrezikshme, mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë;

j) Tregtimi i paligjshëm i aseteve historike dhe kulturore, veprave të artit dhe metaleve të çmuara;

k) Falsifikimi i parave, dokumenteve me vlerë, pasaporta, viza dhe dokumente të tjera zyrtare;

l) Vepra penale ne fushën e aktivitetit të huaj ekonomik;

m) Pastrimi i aseteve të fituara nga veprat penale;

n) Shkelje të së drejtës intelektuale dhe të pronësisë;

o) Vepra penale kundër mjedisit;

p) Krimet kompjuterike;

r) Vjedhjet e makinave;

s) Shkeljet e të miturve;

t) Të gjitha llojet e veprave të kontrabandës, veçanërisht, kontrabanda e cigareve dhe mallrave, të akcizës së lartë;

u) Bashkëpunimi dypalësh dhe metodat e luftës në fushën e abuzimit të fëmijëve në internet;

v) Krimet e vrasjes, uzurpimit, vjedhjes, zhvatjes dhe grabitjes;

y) Njerëzit e humbur të kërkuar.

2. Palët caktojnë reciprokisht oficerë ndërlidhës në misionet e tyre diplomatike në mënyrë që të rritet efikasiteti i ndërveprimit dhe koordinimit të veprimeve të përbashkëta brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje.

3. Palët sipas legjislacionit kombëtar dhe nëpërmjet autoriteteve të tyre kompetente do të bashkëpunojnë për identifikimin, zbulimin, sekuestrimin me qëllim konfiskimin dhe rikuperimin e produkteve të krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme, terrorizmit dhe pastrimit të parave.

Neni 2

Format e bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente të shteteve të Palëve Kontraktuese kryhet në përputhje me legjislacionin kombëtar në format e mëposhtme:

a) Shkëmbimi i informacionit mbi rrethanat që mund të ndihmojnë për të parandaluar kërcënimet ndaj rendit dhe sigurisë publike, si dhe për të parandaluar dhe për të zbuluar veprat penale;

b) Shkëmbimi i eksperiencës në fushën e zbatimit të instrumenteve ligjore që kanë të bëjnë me parandalimin e krimit dhe luftën ndaj terrorizmit dhe që aplikohen ndaj formave e metodave të reja dhe mënyrave të kryerjes se ekzaminimeve mjekoligjore;

c) Shkëmbimi i informacionit lidhur me format dhe metodat më efektive në luftën kundër krimit dhe terrorizmit;

d) Kryerja e veprimeve të përbashkëta të koordinuara nga autoritetet kompetente të Shteteve të Palëve që kanë për qëllim parandalimin e kërcënimeve ndaj rendit dhe sigurisë publike, parandalimin e akteve terroriste, si edhe parandalimin dhe zbulimin e veprave penale duke përfshire dërgesat e kontrolluara;

e) Shkëmbimi i informacionit mbi personat që u shmangen akteve procedurale gjyqësore;

f) Shkëmbimi i informacionit mbi identifikimin e kufomave;

g) Shkëmbimi i informacionit lidhur me identifikimin, zbulimin, sekuestrimin, konfiskimin dhe kthimin e aseteve të krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme, terrorizmit dhe pastrimit të parave.

Neni 3

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Palëve ndihmojnë njëri-tjetrin mbi bazë kërkese.

2. Kërkesat për dhënie asistence dhe përgjigjet e tyre përcillen me shkrim. Në rast emergjence,

kërkesat mund të dërgohen verbalisht, të pasuara menjëherë nga konfirmimi me shkrim me përdorimin e mënyrave teknike të dërgimit të të dhënave.

Kërkesa për marrjen e informacionit përmban:

- emrin e autoritetit kompetent kërkues dhe autoritetin kompetent të kërkuar;

- formulimin e thelbit të çështjes dhe arsyetimin për të, si dhe informacionin mbi ekzekutimin e saj.

3. Informacioni dhe dokumentet, të marra në përputhje me kushtet e këtij neni, nuk i dërgohen një pale të tretë pa marrë miratimin paraprak të Palës dërguese.

4. Në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, secila Palë mund të refuzojë, plotësisht ose pjesërisht, një kërkesë për ndihmë nëse Pala e kërkuar vlerëson se përmbushja e saj mund të kërcënojë sovranitetin, sigurinë dhe interesa të tjera jetike të shtetit të saj, ose nëse kërkesa nuk është në përputhje me legjislacionin kombëtar të shtetit të Palës, ose cenon detyrimet e saj që rrjedhin nga marrëveshje ndërkombëtare. Në këtë rast, Pala e kërkuar njofton menjëherë Palën kërkuese mbi refuzimin dhe jep informacion ose shpjegon arsyet e saj.

5. Në përputhje me këtë Marrëveshje, shkëmbimi i informacionit të kufizuar kryhet në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palëve.

Neni 4
Autoritetet kompetente

1. Autoritetet kompetente të Palëve për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë si më poshtë:

Për Palën Shqiptare:

Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë

Për Palën Turke: Ministria e Brendshme.

Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të shteteve të Palëve mund të nënshkruajnë protokolle, të ngrenë grupe pune, të organizojnë takime ekspertësh dhe të kryejnë aktivitete të koordinuara.

Neni 5
Format e bashkëpunimit në luftën kundër terrorizmit

a) Palët do të marrin masa eficiente për parandalimin e përgatitjes dhe kryerjes së akteve terroriste brenda territorit të tyre, kundër qytetarëve dhe sigurisë së Palës tjetër.

b) Bashkëpunimi në luftën kundër terrorizmit do të mbulojë veçanërisht bashkëpunimin në shërbimin e informimit, zbulimit, vlerësimin e përbashkët dhe bashkëpunimin operacional në lidhje me organizatat terroriste dhe mënyrat e tyre të veprimit, aktet terroriste, financimin e terrorizmit, të cilat cenojnë sigurinë e Palëve, teknikat e metodat e përdorura në luftën kundër terrorizmit.

c) Në luftën kundër terrorizmit, Palët nuk do të lejojnë aktivitetet e *website*-ve, bloget e medies vizive dhe të shkruar të organizatave terroriste dhe institucionet e tyre të para të veprojnë në territorin e tyre kundër Palës tjetër. Palët do t'i konsiderojnë ato si organizata të paligjshme dhe do të marrin masat e duhura në këtë fushë në përputhje me legjislacionin e tyre.

d) Palët do të zhvillojnë dhe do të zbatojnë masa efektive të luftës në lidhje me personat dhe institucionet që sigurojnë mbështetje financiare, si: strehim, akomodim, trajnim dhe trajtim e mbështetje logjistike për organizatat terroriste në territoret e tyre.

e) Palët do të shkëmbejnë informacion dhe përvojë në lidhje me metodat e parandalimit dhe luftës kundër terrorizmit duke përfshirë veprat penale të pengmarrjeve dhe rrëmbimeve të avionit dhe do të kryejnë studime të përbashkëta për çështjet e përmendura.

f) Palët do të shkëmbejnë informacion dhe përvojë në lidhje me armët, pajisjet dhe instalimet teknike të përdorura në luftën kundër terrorizmit. Ata do të sigurojnë trajnime reciproke për personelin e njësive që merren me terrorizmin dhe në këtë drejtim ata do të organizojnë kurse trajnimi, seminare dhe takime konsultative duke bashkëpunuar në fushën e analizimit të natyrës, dinamikës dhe formave të terrorizmit.

g) Palët do të shkëmbejnë informacion duke monitoruar lëvizjet e pajisjeve teknologjike, të të gjitha llojeve të armëve dhe municioneve, të cilat mund të përdoren për përgatitjen e kryerjen e akteve terroriste me qëllim për parandalimin e organizatave terroriste nga blerja e këtyre pajisjeve.

h) Palët do të shkëmbejnë informacion nëpërmjet autoriteteve të tyre kompetente për të bashkëpunuar për identifikimin, zbulimin, sekuestrimin me qëllim konfiskimin dhe rikuperimin e produkteve të krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme, terrorizmit dhe pastrimit të parave.

Neni 6

Format specifike të bashkëpunimit në fushën e luftës kundër krimit të organizuar

1. Në pajtim me legjislacionin e tyre kombëtar, autoritetet kompetente të Palëve do të shkëmbejnë informacion rreth:

a) strukturës, përbërjes, fushave të aktivitetit dhe kontakteve të jashtme të grupeve të organizuara dhe organizatave kriminale, aktivitetet e të cilave kanë karakter ndërkombëtar;

b) formave dhe metodave të kryerjes së aktiviteteve të paligjshme nga grupe të organizuara, duke përfshirë pastrimin e parave;

c) aktivitetit konkret të paligjshëm, të planifikuar ose të kryer nga anëtaret e grupeve të organizuara dhe organizatat kriminale në territoret e shteteve të Palëve Kontraktuese;

d) kritereve të vlerësimit të situatës operative në luftën kundër krimit të organizuar.

Neni 7

Format specifike të bashkëpunimit në fushën e kultivimit dhe të trafikimit të paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope

1. Në pajtim me legjislacionin e tyre kombëtar, autoritetet kompetente të Palëve bashkëpunojnë me synimin për të luftuar trafikun e paligjshëm të lëndëve narkotike, nëpërmjet:

a) shkëmbimit të informacionit rreth përpjekjeve për të bërë kontrabandë të lëndëve narkotike ose substancave psikotrope në territorin e shtetit të njërës prej Palëve;

b) shkëmbimit të informacionit rreth formave dhe mjeteve që janë përdorur gjatë kalimit kufitar, si edhe metodat për zbulimin e tyre;

c) shkëmbimit të informacionit rreth personave që janë përfshirë në trafikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike ose substancave stimuluese, si dhe rreth itinerareve të mjeteve të zbuluara për transportimin e këtyre lëndëve dhe substancave;

d) shkëmbimit të informacionit rreth formave dhe metodave të pastrimit të parave të fituara nga prodhimi dhe trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike ose substancave psikotrope, substancat e tyre dhe prekursorëve të përdorur në prodhimin e tyre;

e) shkëmbimit të ndërsjellë të rezultateve të kërkimit mbi çështje që lidhen me luftën kundër trafikimit të paligjshëm të lëndëve narkotike.

2. Autoritetet kompetente, të cilat janë të autorizuara në përputhje me legjislacionet e tyre kombëtare, marrin në konsideratë mundësinë e përdorimit të metodës së dërgesave të kontrolluara.

Neni 8

Format specifike të bashkëpunimit në fushën e luftës kundër migracionit dhe trafikimit të paligjshëm të qenieve njerëzore

1. Në pajtim me legjislacionet e tyre kombëtare, autoritetet kompetente të shteteve të Palëve shkëmbejnë informacion mbi metodat dhe itineraret e migracionit të paligjshëm të organizuar dhe, gjithashtu, informacion që lidhet me kontrollin e pasaportave dhe vizave dhe ekzemplarët e këtyre dokumenteve, të cilat legalizojnë kalimin e kufirit shtetëror; shtojcat e këtyre dokumenteve; llojet e vizave dhe simboleve. Informimi i ndërsjellë rreth lëvizjes së lirë dhe procedurës së lëshimit të pasaportave dhe rreth aspekteve të përdorimit të kufizimeve do të sigurohet nga Palët.

2. Në pajtim me legjislacionin e tyre kombëtar, autoritetet kompetente të shteteve të Palëve organizojnë bashkëveprimin e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, konkretisht:

a) shkëmbimin e informacionit rreth trafikantëve të qenieve njerëzore dhe viktimave të aktiviteteve të tyre të paligjshme;

b) organizimin e operacioneve rajonale mbi asgjësimin e kanaleve ndërkombëtare të trafikimit të qenieve njerëzore.

Neni 9

Format e veçanta të bashkëpunimit në luftën kundër krimeve kompjuterike

1. Në pajtim me legjislacionin e tyre kombëtar, autoritetet kompetente të Palëve shkëmbejnë informacion mbi:

a) aktivitetin e paligjshëm të organizatave, grupeve dhe personave të veçantë, të cilët veprojnë në fushën e përdorimit të informacionit dhe të teknologjisë së komunikimit të Palëve dhe kërcënojnë sigurinë e tyre;

b) softuerë dhe harduerë të dëmshëm (virus, Trojan etj.), si dhe mjeteve të tjera të dëmshme, të cilat mund të shkaktojnë çaktivizimin e objekteve me rëndësi jetësore ose përhapjen, humbjen dhe keqpërdorimin e informacionit të mbrojtur;

c) metodat dhe mjetet e mbrojtjes kundër softuerëve të dëmshëm, dhe kërcënimeve të tjera

moderne kibernetike, të përfshirë në informacionin dhe teknologjitë e komunikimit;

d) shkëmbim i informacionit dhe eksperiencës lidhur me teknikat dhe metodat e kërkimit të teknikës kompjuterike me synimin e mbledhjes së informacionit në procesin e hetimit të aktiviteteve kriminale;

e) përmirësimin e sigurisë së informacionit dhe teknologjisë së komunikimit dhe legjislacioni përkatës, si dhe legjislacioni, i cili rregullon çështjet për sa i përket parandalimit, zbulimit dhe goditjen e krimeve në fushën e përdorimit të informacionit dhe sistemeve të komunikimit.

Neni 10
Bashkëpunimi në trajnime

Palët mund të bashkëpunojnë në fushën e Programit të Certifikimit të Trajnimeve, Programit të Certifikimit të Trajnimit Bazë të Policisë, Programit të Certifikimit të Nivelit të Parë Drejtues, programe pasuniversitare dhe doktorale.

Neni 11
Mbrojtja e të dhënave personale

Autoritetet kompetente të Palëve transferojnë të dhëna personale në pajtim me legjislacionin e tyre kombëtar, si dhe me kushtet e mëposhtme që zbatohen:

1. Të dhënat e dërguara duhet të përdoren ekskluzivisht për qëllimet për të cilat ato janë dhënë;

2. Me kërkesën e Palës dërguese, institucioni që merr të dhënat jep informacion mbi përdorimin e tyre brenda 30 ditëve kalendarike;

3. Autoriteti kompetent, i cili i jep këto të dhëna, siguron vërtetësinë dhe saktësinë e tyre. Nëse këto të dhëna provohen se janë të pavërteta ose përhapja e tyre konfirmohet se është e ndaluar për shkak të kërkesave të legjislacionit, autoriteti, i cili merr të dhënat njoftohet menjëherë për këtë dhe asgjëson ose korrigjon këto të dhëna sipas pikës 4.

4. Të dhënat e dërguara asgjësohen ose korrigjohen në rastet e mëposhtme:

a) Nëse provohet pasaktësia e këtyre të dhënave;

b) Autoriteti kompetent dërgues njofton që këto të dhëna u mblodhën ose u dhanë në kundërshtim me ligjin;

c) Të dhënat nuk janë më të nevojshme për përmbushjen e detyrës për të cilën u dhanë, përveç kur ekziston një leje me shkrim që të dhënat e dërguara mund të përdoren për qëllime të tjera.

5. Nëse autoriteti që merr të dhënat ka arsye të vlerësojë se të dhënat e dërguara janë të pasakta ose duhet të shkatërrohen, ai njofton për këtë autoritetin dërgues.

6. Autoriteti që jep të dhënat është i detyruar të shmangë këto të dhëna nga fshirja, hyrja e paautorizuar, ndryshimet ose përhapja e tyre.

7. Me dërgimin e të dhënave, autoriteti dërgues dhe autoriteti marrës do të përpilojnë një protokoll për të regjistruar dërgimin dhe marrjen e këtyre të dhënave dhe për të vendosur mbi procedurat për sa u përket këtyre të dhënave.

8. Palët kanë detyrimin për të ruajtur konfidencialitetin dhe besueshmërinë e të dhënave edhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje. Këto të dhëna nuk duhet të përhapen përveç rasteve të parashikuara në legjislacionet respektive.

Neni 12
Konsultimet

Autoritetet kompetente të shteteve të Palëve Kontraktuese, nëse është e nevojshme, mund të ndërmarrin konsultime dhe takime pune për të diskutuar masat për sa i përket zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13
Komisioni i Përbashkët

1. Palët Kontraktuese krijojnë një Komision të Përbashkët për koordinimin dhe vlerësimin e bashkëpunimit në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje. Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën nëpërmjet rrugëve diplomatike për përfaqësuesit e tyre në Komisionin e Përbashkët brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

2. Komisioni i Përbashkët mblidhet sa herë që është e nevojshme. Secila prej Palëve Kontraktuese mund të iniciojë takimet e Komisionit të Përbashkët.

3. Komisioni i Përbashkët ndërmerr takimet e tij në mënyrë të njëpasnjëshme në Republikën e Turqisë dhe në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14
Shpenzimet

Të gjitha shpenzimet që u përkasin aktiviteteve brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje të kryera, përveç shpenzimeve të udhëtimit ndërkombëtar, përballohen nga Pala pritëse.

Neni 15
Raporti me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare

Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet që parashikohen nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare në të cilat bëjnë pjesë Palët.

Neni 16
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje në interpretimin dhe në zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje zgjidhet nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve.

2. Në rast se nuk arrihet në konsensus në procesin e konsultimeve dhe të bisedimeve sipas paragrafit 1, çështja zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 17
Hyrja ne fuqi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nga i cili Palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përmbushjen e procedurave të tyre të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi.

2. Kjo Marrëveshjeje do të mbetet në fuqi për një periudhë 5-vjeçare. Secila Palë mund njoftojë Palën tjetër në çdo kohë me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike rreth qëllimit të saj për të përfunduar Marrëveshjen 6 muaj para skadimit. Ajo duhet të rinovohet automatikisht për një periudhë pasardhëse prej 1 viti, përveç rastit kur njëra nga Palët njofton me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike rreth qëllimit të saj për të përfunduar Marrëveshjen 6 muaj para skadimit.

3. Me miratimin e përbashkët të Palëve Kontraktuese, kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me anë të protokolleve të veçanta, të cilat janë pjesë integrale e Marrëveshjes.

4. Në rastin e përfundimit të Marrëveshjes të gjitha veprimtaritë të nisura nga kjo Marrëveshje do të ndërmerren nën termat dhe kushtet e saj.

Bërë më 13 maj 2015, në Tiranë, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, turke dhe angleze, duke qenë të gjitha tekstet njëlloj autentike. Në rast, mosmarrëveshjesh në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, do të mbizotërojë teksti në anglisht.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë
Saimir Tahiri
MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME

Për qeverinë e Republikës së Turqisë
Sebahattin Ozturk
MINISTËR I BRENDSHËM

VENDIM
Nr. 585, datë 1.7.2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 439, DATË 13.5.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT "POLITIKAT DHE PROCEDURAT E FUNKSIONIMIT TË QENDRËS NDËRINSTITUCIONALE OPERACIONALE DETARE (QNOD)""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 128, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative", të ndryshuar, dhe të pikës 1, të kreut IV, të vendimit nr. 954, datë 30.9.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin, strukturën, funksionimin e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD)", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në dokumentin "Politikat dhe procedurat e funksionimit të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD)", të miratuar me vendimin nr. 439, datë 13.5.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2, të "Pjesës së përgjithshme", shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

"2.1 DETYRAT E QNOD-së

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) është një strukturë ndërinstitucionale bashkërenduese që ka detyrë organizimin, planizimin dhe drejtimin e operacioneve detare në të gjithë hapësirën detare, në përputhje me legjislacionin detar, vendës e ndërkombëtar.

Kjo qendër koordinon drejtimin e veprimtarive të kontrollit të zbatimit të ligjit, që realizohen në hapësirën detare, zonat ujore dhe rajonet e përgjegjësisë, që mbulohen nga institucionet përkatëse të interesuara.

Qendra përdor me efikasitet burimet shtetërore për të garantuar ushtrimin e sovranitetit dhe të të drejtave sovrane të shtetit shqiptar në det. Për të realizuar objektivat dhe synimet që burojnë nga misioni, formulohen dhe përqasen listime detyrash konkrete, të cilat përfshijnë të gjithë fushën e misionit.

Kërkesat për të operuar në hapësirën detare, në interes të zbatimit të ligjit dhe të ushtrimit të sovranitetit shtetëror, janë bazat themelore të funksionimit të QNOD-së, të sistemeve dhe mjeteve që ajo ka në dispozicion për realizimin e veprimtarive administrative-juridike e operacionale. Organizimi i QNOD-së për të kryer veprime operacionale të ushtrimit të kontrollit për zbatimin e ligjit bëhet me anë të grupeve funksionale, të drejtuara sipas linjës hierarkike të drejtimit, duke filluar nga eprori kryesor tek oficerët ekzekutivë të qendrës deri te komandantët në terren, të cilët kontrollojnë të gjithë aktivitetin e personelit në varësi të tyre. Një kontroll i tillë është i domosdoshëm për të realizuar efektivitetin e aseteve teknike e njerëzore të QNOD-së për të përmbushur objektivat dhe synimet e çdo plani operacional të zbatimit të ligjit në det.

Drejtimi i operacioneve detare bazohet në forcimin e vazhdueshëm të kontrollit civil mbi këto aktivitete dhe funksionimin ligjor të strukturave të kontrollit të kufijve detarë dhe të imponimit të ligjit në hapësirën detare. Në këtë mënyrë ai garanton zbatimin e kërkesave ligjore për ushtrimin e sovranitetit dhe të së drejtës sovrane të shtetit shqiptar në hapësirën detare.

QNOD-ja e siguron drejtimin e saj civil, nëpërmjet organizimit strukturor, legjislacionit kombëtar në fuqi, si dhe legjislacionit ndërkombëtar mbi detin, të ratifikuar nga vendi ynë. Të gjitha aktet nënligjore dhe normative, në bazë të të cilave udhëhiqet veprimtaria e përditshme dhe ajo operacionale e QNOD-së, burojnë nga legjislacioni i mësipërm civil.”.

2. Kapitulli III, i pjesës I, shfuqizohet.

3. Kapitujt II dhe III, të pjesës II, ndryshohen si më poshtë vijon:

“KAPITULLI II

Struktura organizative dhe misionet për institucionet (përfaqësuesit) pjesëmarrëse në QNOD

1. Struktura organizative dhe organigrama

1.1 Struktura organizative

QNOD-ja ka në përbërje strukturore personel nga institucionet që kanë kompetenca dhe kryejnë detyra në hapësirën detare, sipas nenit 32, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, siç janë:

- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (prani 24-orëshe të administratës detare);
- Ministria e Punëve të Brendshme (prani 24-orëshe të Policisë së Kufirit dhe Migracionit);
- Ministria e Mbrojtjes (prani 24-orëshe të Rojës Bregdetare);
- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (prani 24-orëshe të Drejtorisë së Shërbimeve Peshkore dhe Akuakulturës);
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (kapacitet bashkërendues sipas nevojës);
- Ministria e Financave (kapacitet bashkë-rendues sipas nevojës);
- Ministria e Mjedisit (kapacitet bashkërendues sipas nevojës).

Personeli i caktuar nga këto institucione në QNOD përfaqëson institucionin përkatës dhe është në varësi administrative të drejtorit administrativ të QNOD-së.

Përbërja e strukturës së QNOD-së është, si më poshtë vijon:



- Drejtori administrativ i QNOD-së;
- Administratorët e sallës operacionale;
- Koordinatorët e ministrive të linjës;
- Drejtoria e Planifikimit dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- Oficerët e shërbimit/oficerët civilë të turnit të ministrive të linjës;
- Operatorët e sistemit dhe operatorët e komunikimit.

1.2 Organigrama

Drejtimi i operacioneve detare bazohet në forcimin e vazhdueshëm të kontrollit civil mbi këto aktivitete dhe funksionimin ligjor të strukturave të kontrollit të kufijve detarë dhe të zbatimit të ligjit në hapësirën detare. Në këtë mënyrë, ai garanton zbatimin e kërkesave ligjore për ushtrimin e sovranitetit dhe të së drejtës sovrane të shtetit shqiptar në hapësirën detare.

QNOD-ja siguron koordinimin civil të operacioneve në det nëpërmjet organizimit të saj strukturor. Të gjitha aktet nënligjore dhe normative, në bazë të të cilave udhëhiqet veprimtaria e përditshme dhe ajo operacionale e QNOD-së, burojnë nga legjislacioni civil, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Përputhja e hierarkisë së drejtimit për komandantët në terren me nivelet e larta urdhëruese realizohet nëpërmjet dokumenteve normative, të miratuara nga institucionet përkatëse që kanë interesa dhe përgjegjësi në det. Edhe këto dokumente bazohen në legjislacionin ndërkombëtar dhe kombëtar.

Nevoja për shfrytëzimin racional të të gjitha burimeve (përfshi edhe ato ushtarake) për të ushtruar kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në hapësirën detare është realizuar me anë të ligjeve të posaçme.

2. Tabela e organizimit, asetet e QNOD-së dhe të institucioneve pjesëmarrëse

Me asete të QNOD-së do të kuptojmë asetet e QNOD-së, si dhe asetet e institucioneve pjesëmarrëse, ku përfshihen personeli, mjetet detare, sistemet e vëzhgimit, ndërlidhjes dhe informimit etj., të vëna në dispozicion të QNOD-së.

Një rëndësi të veçantë në mbështetje të veprimtarisë operacionale dhe administrative të QNOD-së luajnë: Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare; Sistemi i Monitorimit dhe i Mbikëqyrjes Blue-Box; Sistemi SMART; TIMS; MEMEX dhe sistemet e ndërlidhjes dhe radio-komunikimit TETRA, të cilat u shërbejnë QNOD-së dhe të gjitha institucioneve pjesëmarrëse në të, në funksion të përmbushjes së përgjegjësive të tyre në hapësirën detare.

Roja Bregdetare dhe institucionet e tjera pjesëmarrëse në QNOD, të përfshira në nenin 32, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", janë të detyruara të deklarojnë asetet dhe kapacitetet e tyre operacionale dhe t'i vënë në dispozicion të QNOD-së, në interes të bashkëpunimit ndër-institucional dhe realizimit të misionit të kësaj qendre. Plani i zhvillimit të këtyre kapaciteteve do të hartohet në QNOD në bashkëpunim me të gjitha këto institucione dhe do t'i paraqitet ministrit të Mbrojtjes për t'u miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Institucionet pjesëmarrëse në QNOD informojnë në mënyrë periodike për asetet në dispozicion të QNOD-së në bazë të kërkesave të vendimit nr. 954, datë 30.9.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të procedurave standarde operacionale dhe procedurave të institucioneve për përhapjen, venddislokimet dhe mjetet në gatishmëri.

Informacioni i përditësuar i mjeteve dhe pajisjeve në dispozicion të QNOD-së shpallet në përputhje me rregulloren e brendshme të QNOD-së.".

KAPITULLI III

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të personelit dhe të përfaqësuesve të institucioneve pjesëmarrëse në QNOD.

1. Drejtori administrativ

Drejtori administrativ i QNOD-së është drejtuesi më i lartë i institucionit që ngarkohet me autoritet dhe përgjegjësi për të siguruar drejtimin, mbarëvajtjen, funksionimin dhe efektivitetin e qendrës, si dhe të njësive që varen apo jepen përkohësisht në varësi të saj. Ai emërohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes.

1.1 Drejtori administrativ i QNOD-së ka përgjegjësi të përgjigjet për zbatimin e misionit të QNOD-së nëpërmjet planifikimit, koordinimit të punës dhe zbatimit të procedurave standarde e planeve operacionale në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.

1.2 Drejtori administrativ i QNOD-së ka këto detyra:

a) Të drejtojë strukturën organizative në përbërje të QNOD-së, në mënyrë sa më efikase.

b) Të konsultohet me titullarët e institucioneve që marrin pjesë në QNOD për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ushtrimin e sovranitetit në det, si dhe të mbajë lidhje me të gjitha nivelet ekzekutive të institucioneve përfaqësuese.

c) Të kërkojë zbatimin e procedurave standarde të miratuara në përputhje me legjislacionin

kombëtar dhe ndërkombëtar. Për çdo problem administrativ jep detyra dhe informon titullarët e institucioneve pjesëmarrëse.

ç) Të nxjerrë urdhra dhe udhëzime në përputhje me kuadrin ligjor në zbatim të veprimtarisë dhe misionit të kësaj qendre.

d) Të drejtojë dhe të koordinojë punën me koordinatorët e institucioneve dhe administratorët e sallës operacionale për planëzimin, organizimin dhe zbatimin e planeve operacionale.

dh) Të drejtojë analiza të planifikuara ose emergjente me personelin e qendrës dhe koordinatorët e institucioneve, si dhe me drejtuesit e institucioneve pjesëmarrëse në QNOD për probleme konkrete të përmbushjes së misionit.

e) Të kërkojë raportim zyrtar të detajuar me shkrim dhe në rrugë elektronike, të shoqëruara me prova përkatëse shtesë (pamjet filmike ose fotografike, të dhëna nga regjistrimet e sistemit, vendndodhja, ora, data etj.) në përfundim të çdo operacioni nga koordinatorët institucionalë dhe administratorët e sallës operacionale për operacionin e kryer.

ë) Të përcaktojë regjimin juridik të operacionit në ato raste kur nuk arrihet konsensusi për marrjen e një vendimi të përbashkët nga oficerët e shërbimit/oficerët civilë të turnit, administratori i sallës dhe koordinatorët institucionalë.

f) Të hartojë raporte periodike për Kryeministrin dhe titullarët e ministrive pjesëmarrëse për mbarëvajtjen dhe efektivitetin e Qendrës.

g) Të miratojë programet dhe planet e përbashkëta për trajnimin e personelit, përdorimin e integruar të infrastrukturës, investimet e përbashkëta për modernizimin etj.

gj) Të hartojë dhe të paraqesë buxhetin vjetor pranë ministrit të Mbrojtjes.

h) Të iniciojë pranë titullarëve të institucioneve përmirësimin e kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e QNOD-së.

i) T'u propozojë masa konkrete titullarëve të institucioneve përkatëse për personelin pjesëmarrës në QNOD.

j) Të përfaqësojë QNOD-në në marrëdhëniet me institucionet e tjera, kombëtare dhe ndërkombëtare.

1.3 Arsimimi, kualifikimi dhe eksperienca e drejtorit administrativ:

- Të ketë kryer arsimin e lartë.
- Të ketë mbi 10 (dhjetë) vjet eksperiencë pune në administratën shtetërore.
- Të ketë aftësi planifikuese dhe të zotërojë metodën e punës në grup.
- Të ketë kryer trajnime në fushat që mbulon.
- Të njohë një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze.
- Të njohë programet bazë të kompjuterit.

1.4 Shkalla e sigurisë: Niveli "B", sekret

2. Drejtoria e Planifikimit dhe Shërbimeve Mbështetëse

Drejtori i Planifikimit dhe Shërbimeve Mbështetëse

Drejtori i Planifikimit dhe Shërbimeve Mbështetëse është ndihmësi kryesor i drejtorit administrativ dhe varet prej tij.

2.1 Drejtori i Planifikimit dhe Shërbimeve Mbështetëse ka përgjegjësi të përgjigjet për hartimin dhe rishikimin e procedurave, programeve, urdhrave e udhëzimeve; kontrollin dhe koordinimin ndërinstitucional të planifikimit dhe të aktiviteteve; mbështetjen logjistike dhe juridike për mirëfunksionimin e strukturës organike në varësi të tij.

2.2 Drejtori i Planifikimit dhe Shërbimeve Mbështetëse ka këto detyra:

a) Të koordinojë punën midis sektorëve për përmbushjen e misionit të QNOD-së.

b) Të zhvillojë, të koordinojë, të monitorojë dhe të kontrollojë programet dhe planëzimet e QNOD-së, duke vënë theks të veçantë në aktivitetet e përgjithshme administrative.

c) Të ndihmojë drejtorin administrativ në administrimin e përgjithshëm të qendrës.

ç) Të informojë vazhdimisht drejtorin për problemet dhe pengesat që hasen gjatë realizimit të detyrave për zbatimin e politikave e të programeve të organizimit.

d) Të drejtojë aktivitetin e sektorëve që varen prej tij me synimin kryesor koordinimin efektiv të tyre me institucionet bashkëvepruese.

dh) Të administrojë dosjet e personelit dhe të evidentojë të dhënat e personelit të QNOD-së.

e) Të drejtojë vlerësimin e misioneve dhe programeve të sektorëve; rishikimin e mbështetjes ligjore funksionale etj.

ë) Të organizojë punën për hartimin e planit buxhetor dhe të ndjekë zbatimin e tij.

f) Të ndikojë në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të trajnimit të efektivave të QNOD-së.

2.3 Arsimimi, kualifikimi dhe eksperienca e drejtorit të Planifikimit dhe Shërbimeve Mbështetëse:

- Të ketë kryer arsimin e lartë.
- Të ketë mbi 10 (dhjetë) vjet eksperiencë në administratën shtetërore.
- Të ketë aftësi planifikuese dhe të zotërojë metodën e punës në grup.
- Të ketë kryer trajnime dhe kualifikime në fushat përkatëse.
- Të njohë një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze.
- Të njohë programet bazë të kompjuterit.

2.4 Shkalla e sigurisë: Niveli "B", sekret.

3. Sektori i analizës, planifikimit dhe trajnimit

Përgjegjësi i sektorit

Përgjegjësi i sektorit të analizës, planifikimit dhe trajnimit është në varësi të drejtorit të Planifikimit dhe Shërbimeve Mbështetëse.

3.1 Përgjegjësi i sektorit të analizës, planifikimit dhe trajnimit ka përgjegjësi të përgjigjet për organizimin dhe planifikimin operacional të aseteve dhe të burimeve në mbështetje të QNOD-së për trajnimin profesional të personelit të QNOD-së, si dhe evidentimin e grumbullimin e informacioneve.

3.2 Përgjegjësi i sektorit të analizës, planifikimit dhe trajnimit ka këto detyra:

a) Të organizojë dhe të drejtojë punën për planifikimin, programimin dhe zbatimin e programeve të trajnimit për efektivin e QNOD-së.

b) Të evidentojë dhe të njohë në çdo kohë gjendjen dhe dislokimin e mjeteve e të personelit në dispozicion të QNOD-së, në përputhje me raportet e dhëna nga institucionet pjesëmarrëse.

c) Të ushtrojë kontrolle për eficiencën e punës së sallës operacionale.

ç) Të ndihmojë për përshtatshmërinë ligjore në përpilimin e urdhrave dhe udhëzimeve, si dhe në zgjidhjen e situatave të ndryshme që mund të lindin gjatë operacioneve detare.

d) Të planëzojë, të organizojë dhe të menaxhojë në bashkëpunim me koordinatorët e institucioneve procedurat standarde të punës dhe formatet e ndryshme të raportimit.

dh) Të evidentojë dhe të grumbullojë të dhënat e faktet për analizat e ngjarjeve dhe riskut.

e) Të planëzojë, të ndjekë, të koordinojë, të drejtojë dhe të zhvillojë stërvitjet e përbashkëta me të gjitha strukturat pjesëmarrëse në QNOD.

ë) Të identifikojë problemet dhe në bazë të tyre të programojë punën për përmirësimet përkatëse në programet e trajnimeve të ardhshme.

f) Të përgatitë projektbuxhetin vjetor për zyrën e trajnimeve, në varësi të planit vjetor të trajnimeve.

g) Të hartojë planin e punës së sektorit.

3.3 Arsimimi, kualifikimi dhe eksperienca e përgjegjësit të sektorit të analizës, planifikimit dhe trajnimit:

- Të ketë kryer arsimin e lartë (preferohet Akademia e Detarisë).
- Të ketë mbi 10 (dhjetë) vjet përvojë pune në administratën publike ose në institucionet detare të ushtrimit të ligjit.
- Të ketë aftësi planifikuese dhe të zotërojë metodën e punës në grup.
- Të jetë i kualifikuar dhe i trajnuar për fushat përkatëse.
- Të njohë një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze.
- Të njohë programet bazë të kompjuterit.

3.4 Shkalla e sigurisë: Niveli "B", sekret.

4. Specialisti i bazës së të dhënave

4.1 Specialisti i bazës të të dhënave ka përgjegjësi të përgjigjet për marrjen, përpunimin, ruajtjen dhe menaxhimin e informacionit të marrë nga sistemet.

4.2 Specialisti i bazës së të dhënave ka këto detyra:

a) Të njohë mirë arkitekturën e ndërtimit të sistemeve dhe mënyrën e funksionimit të tyre.

b) Të menaxhojë dhe të grumbullojë të dhënat e marra nga sistemet, si dhe të krijojë ndërfaqe të reja për mirëmenaxhimin e informacionit në qendër.

c) Të mirëmbajë serverët e nevojshëm për menaxhim të qendërzuar të dokumenteve.

ç) Të sigurojë projektimin dhe zhvillimin e strategjive të bazës së të dhënave.

d) Të jetë i gatshëm në çdo kohë për situata të mundshme ku kërkohet ndërhyrje teknike.

dh) Të ndihmojë në trajnimin e personelit që përdor softet në grumbullimin e bazës së të dhënave.

e) Të përgatitë dhe të paraqesë prezantime të qarta dhe informuese rreth softeve menaxhuese së të dhënave.

ë) Të bëjë relacione dhe sugjerime për grupin e punës mbi analizën e ngjarjeve dhe riskut.

f) Të mirëmbajë internetin dhe të administrojë faqen web www.imoc.gov.al.

4.3 Arsimimi, kualifikimi dhe eksperienca e specialistit të bazës së të dhënave:

- Të jetë i diplomuar në degët elektronikë ose informatikë.
- Të ketë përvojë pune mbi 3 (tre) vjet në fushën e elektronikës dhe informatikës.
- Të ketë aftësi planifikuese dhe të zotërojë metodën e punës në grup.
- Të ketë trajnimet bazë të nevojshme në fushën e elektronikës dhe të informatikës.
- Të njohë një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze.

4.4 Shkalla e sigurisë: Niveli "B", sekret.

5. Specialist i trajnimeve detare

5.1 Specialisti i trajnimeve detare ka përgjegjësi të përgjigjet për zhvillimin dhe ndjekjen e kualifikimit të vazhdueshëm të personelit të QNOD-së.

5.2 Specialisti i trajnimeve detare ka këto detyra:

a) Të planifikojë, të programojë dhe të zhvillojë në bashkëpunim me koordinatorët institucionalë trajnimet për kualifikimin e vazhdueshëm të efektivave të QNOD-së.

b) Të rishikojë në vazhdimësi programet dhe udhëzimet stërvitore, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të tyre.

c) Të evidentojë arritjet si dhe të përcaktojë objektivat e domosdoshëm në stërvitjet dhe trajnimet e ndryshme që kanë për qëllim rritjen e efektivitetit të personelit.

ç) Të ndihmojë në implementimin dhe zhvillimin e stërvitjeve të vazhdueshme me situata dhe skenarë virtualë në sistemin e vrojtimit, kontrollit dhe të vëzhgimit bregdetar.

d) Të vlerësojë dhe të evidentojë rezultatet e arritura nga personeli.

dh) Të studiojë dhe të përgjithësojë përvojën e trajnimit duke përdorur vazhdimisht metoda të reja dhe efikase të trajnimit.

e) Të ndjekë zbatimin e kostos së trajnimit dhe të përgatitë raportet e buxhetit për justifikimin e shpenzimeve.

ë) Të ndjekë veprimtaritë ceremoniale të QNOD-së.

5.3 Arsimimi, kualifikimi dhe eksperienca e specialistit të trajnimeve detare:

- Të ketë kryer arsimin e lartë (preferohet Akademia Detare).
- Të ketë mbi 3 (tre) vjet eksperiencë pune.
- Të ketë aftësi planifikuese dhe të zotërojë metodën e punës në grup.
- Të ketë kryer trajnime në fushën e specialitetit që mbulon.
- Të njohë një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze.
- Të njohë programet bazë të kompjuterit.

5.4 Shkalla e sigurisë: Niveli "B", sekret.

6. Specialisti i mbështetjes ligjore

6.1 Specialisti i mbështetjes ligjore ka përgjegjësi të përgjigjet për dhënien e asistencës juridike në përpilimin e urdhrave dhe udhëzimeve, në përputhje me bazën ligjore të institucioneve pjesëmarrëse në QNOD.

6.2 Specialisti i mbështetjes ligjore ka këto detyra:

a) Të njohë legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar detar, si dhe të gjitha marrëveshjet e protokollet e nënshkruara e të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

b) Të ndihmojë personelin e QNOD-së për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit detar, kombëtar e ndërkombëtar, për operacionet detare.

c) Të hartojë nisma ligjore për përmirësimin e kuadrit ligjor për mirëfunksionimin e QNOD-së.

ç) Të ndihmojë për përshtatshmërinë ligjore në përpilimin e urdhrave dhe udhëzimeve që merren nga personeli drejtues i QNOD-së.

d) Të interpretojë dhe të japë ndihmën juridike në zgjidhjen e situatave të ndryshme që mund të lindin gjatë operacioneve detare të imponimit të ligjit.

dh) Të ndihmojë personelin në njohjen dhe zbatimin e kërkesave ligjore në veprimtarinë e tyre të përditshme.

6.3 Arsimimi, kualifikimi dhe eksperienca e specialistit të mbështetjes ligjore:

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë juridik.
- Të ketë përvojë pune mbi 3 (tre) vjet në administratën publike.
- Të ketë aftësi planifikuese dhe të zotërojë metodën e punës në grup.
- Të ketë ndjekur trajnime të ndryshme në fushën e legjislacionit ndërkombëtar detar.
- Të njohë një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze.

- Të njohë programet bazë të kompjuterit.

6.4 Shkalla e sigurisë: Niveli "B", sekret.

7. Specialist i sigurisë së TIK-ut (teknologjisë së informacionit dhe komunikimit)

7.1 Specialisti i sigurisë së TIK-ut ka përgjegjësi të përgjigjet për zbatimin e rregullave dhe procedurave të punës për sigurinë e sistemeve dhe informacioneve të marra prej tyre.

7.2 Specialisti i sigurisë së TIK-ut ka këto detyra:

a) Të sigurojë dhe të ruajë në përputhje me procedurat dhe aktet ligjore e nënligjore informacionin dhe nivelin e sigurisë së informacionit në QNOD.

b) Të përcaktojë shkallën dhe zbatimin e masave të plota të sigurisë së institucionit në përputhje me rregulloren e çdo sistemi.

c) Të marrë masa për ruajtjen e të dhënave të sistemeve të informacionit për ngritjen e arkitekturës së informacionit dhe rritjen e standardeve.

ç) Të bëjë kontrollin fizik dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të personelit dhe sallës operacionale të QNOD-së.

d) Të ushtrojë kontrolle dhe inspektime të gjendjes së aparaturave dhe sistemeve në funksion të QNOD-së (Tetra, Blue-Box, Smart etj.), me qëllim që të sigurojë gatishmërinë e sistemeve.

dh) Të mirëmbajë rrjetin LAN dhe të administrojë faqen web www.imoc.gov.al.

e) Të administrojë sistemin "*Access Door*" dhe të mirëmbajë kamerat e brendshme dhe të jashtme.

7.3 Arsimimi, kualifikimi dhe eksperienca e specialistit të sigurisë së TIK-ut:

- Të jetë diplomuar në degët elektronikë ose informatikë.
- Të ketë përvojë pune mbi 3 (tre) vjet në fushën e elektronikës ose informatikës.
- Të ketë aftësi dhe të zotërojë metodën e punës në grup.
- Të ketë kryer trajnimet bazë të nevojshme në fushën e elektronikës dhe informatikës.
- Të njohë një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze.

7.4 Shkalla e sigurisë: Niveli "B", sekret.

8. Sektori i IT-së dhe operatorëve

Përgjegjësi i sektorit të IT-së dhe operatorëve

8.1 Përgjegjësi i sektorit të IT-së dhe operatorëve ka përgjegjësi të përgjigjet për funksionimin dhe gatishmërinë e pandërprerë të sistemeve të komunikimit dhe monitorimit, si dhe aftësimin profesional të personelit.

8.2 Përgjegjësi i sektorit të IT-së dhe operatorëve ka këto detyra*:*

a) Të organizojë dhe të drejtojë punën për gatishmërinë dhe miradministrimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

b) Të jetë i informuar për gjendjen e sistemeve TETRA, SIVHD, Blue-Box, Smart, sistemin e ndërlidhjes në QNOD dhe shkallën e gatishmërisë së tyre.

c) Të organizojë punën për eliminimin në kohë të defekteve dhe të kryejë shërbime profilaktike periodike.

ç) Të evidentojë nevojat dhe të koordinojë punën me sektorin e analizës, planifikimit dhe trajnimeve për trajnimet e nevojshme për specialistët e sektorit që ai mbulon.

d) Të ndjekë dhe të evidentojë problemet që lidhen me sigurinë fizike të infrastrukturës, personelit, informacionit dhe ruajtjen e sekretit etj.

dh) Të hartojë plane për përmirësimet e sistemeve të IT-së dhe komunikimit.

e) Të hartojë planin e punës së sektorit dhe planet e shërbimit.

ë) Të sigurojë masat për ruajtjen e informacionit elektronik.

8.3 Arsimimi, kualifikimi dhe eksperienca e përgjegjësit të sektorit të IT-së dhe operatorëve:

- Të jetë me arsim të lartë në inxhinieri elektronike ose informatike.
- Të ketë eksperiencë pune mbi 5 (pesë) vjet.
- Të ketë aftësi dhe të zotërojë metodën e punës në grup.
- Të ketë trajnimet bazë të nevojshme në fushën e komunikimit dhe sigurisë.
- Të njohë një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze.

8.4 Shkalla e sigurisë: Niveli "B", sekret.

9. Administrator sistemi

9.1 Administratori i sistemit ka përgjegjësi të përgjigjet për menaxhimin dhe mirëfunksionimin e pandërprerë të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

9.2 Administratori i sistemit ka këto detyra:

a) Të njohë mirë arkitekturën e ndërtimit të sistemeve dhe mënyrën e funksionimit të tyre.

b) Të menaxhojë dhe të mbajë në gatishmëri të pandërprerë sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

c) Të mbikëqyrë vazhdimisht gatishmërinë për punë të sistemeve, akordimin e tyre të plotë, gjendjen e antenave, serverëve, kompjuterëve, si dhe të burimeve të ushqimit.

ç) Të bëjë kontrolle dhe inspektime të gjendjes së aparaturave dhe sistemeve në funksion të QNOD-së për të siguruar gatishmërinë e sistemeve.

d) Të riparojë defektet e mundshme. Të jetë i gatshëm në çdo kohë për situata të mundshme ku kërkohet ndërhyrje teknike.

dh) Të mbikëqyrë rrjetin kompjuterik LAN të QNOD-së, si dhe të mirëmbajë internetin e të administrojë faqen web www.imoc.gov.al.

e) Të trajnojë personelin për mënyrën e përdorimit të sistemeve.

ë) Të propozojë projekte të reja me qëllim përmirësimin e atyre ekzistuese.

f) Të përgatitë dhe të paraqesë prezantime informuese rreth sistemeve të vendosura në qendër.

9.3 Arsimimi, kualifikimi dhe eksperienca e administratorit të sistemit:

- Të jetë i diplomuar në degët Elektronikë ose Informatikë.
- Të ketë përvojë pune mbi 3 (tre) vjet në fushën e elektronikës dhe të informatikës.
- Të ketë aftësi dhe të zotërojë metodën e punës në grup.
- Të ketë trajnimet bazë të nevojshme në fushën e elektronikës dhe të informatikës.
- Të njohë një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze.

9.4 Shkalla e sigurisë: Niveli "B", sekret

10. Operatorët e komunikimit

10.1 Operatorët e komunikimit kanë përgjegjësi të përgjigjen për realizimin e vazhdueshëm të komunikimit.

10.2 Operatorët e komunikimit kanë këto detyra:

a) Të njohin dhe të përdorin me profesionalizëm sistemet e komunikimit.

b) Të mbajnë gjithnjë në gatishmëri të plotë mjetet e komunikimit, si dhe *dispatcher*-in e radio-komunikimit TETRA.

c) Të njohin rregullat e komunikimit në det dhe të komandimit operacional.

ç) Të njohin karakteristikat dhe kodet e komunikimit të institucioneve.

d) Të sigurojnë ndërlidhje të pandërprerë me radio dhe telefon.

dh) Të zbatojnë me përpikëri rregullat e komunikimit.

e) Të mbajnë evidentim të plotë në regjistra për shkëmbimin e komunikimit të kryer me institucionet.

10.3 Arsimimi, kualifikimi dhe eksperienca e operatorëve të komunikimit:

- Të kenë mbaruar arsimin e mesëm ose profesional.
- Të kenë trajnimet e nevojshme për realizimin profesional të misionit të tij dhe një eksperiencë pune mbi 5 (pesë) vjet.
- Të njohin një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze.
- Të njohin programet bazë të kompjuterit.

10.4 Shkalla e sigurisë: Niveli "B", sekret.

11. Sektori i financës dhe shërbimeve ndihmëse

Përgjegjësi i sektorit të financës dhe shërbimeve ndihmëse

11.1 Përgjegjësi i sektorit të financës dhe shërbimeve ndihmëse ka përgjegjësi të përgjigjet për administrimin e vlerave materiale e monetare, si dhe për planifikimin e realizimin e buxhetit.

11.2 Përgjegjësi i sektorit të financës dhe shërbimeve ndihmëse ka këto detyra:

a) Të planifikojë dhe të detajojë fondet e miratuara, të ndjekë dhe të zbatojë planin ekonomiko-financiar, të administrojë vlerat materiale dhe monetare të QNOD-së.

b) Të njohë dhe të ndjekë në çdo kohë gjendjen ekonomiko-financiare të QNOD-së.

c) Të zbatojë planin ekonomiko-financiar në të gjithë treguesit e tij.

ç) Të detajojë planin financiar të miratuar nga Ministria Mbrojtjes.

d) Të ndjekë dhe të zbatojë planin kontabël, si dhe të nxjerrë brenda afateve të përcaktuara bilancin e QNOD-së.

dh) Të ndjekë dhe të ushtrojë kontroll të vazhdueshëm në realizimin e zërave të buxhetit dhe administrimin e vlerave materiale e monetare.

e) Të ndjekë dhe të kontrollojë përdorimin e fondeve sipas destinacionit të përcaktuar.

ë) Të mbajë marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me thesarin dhe bankën.

f) Të shkëmbejë informacione të vazhdueshme për probleme financiare dhe të administrimit të vlerave me drejtoritë përkatëse të MM-së.

g) Të pezullojë të gjitha veprimtaritë ekonomike-financiare që janë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

gj) Të hartojë dhe të zbatojë plane kontrolli periodik për administrimin e mirë të ambienteve dhe vlerave materiale të QNOD-së.

11.3 Arsimimi, kualifikimi dhe eksperienca e përgjegjësit të sektorit të financës dhe shërbimeve ndihmëse:

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë, dega ekonomik, financë.
- Të ketë mbi 5 (pesë) vjet përvojë pune në administratën shtetërore në sektorët e financës.
- Të ketë aftësi dhe të zotërojë metodën e punës në grup.
- Të ketë trajnimet bazë të nevojshme në specialitetin e fushës që mbulon.
- Të njohë një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze.
- Të njohë programet bazë të kompjuterit.

11.4 Shkalla e sigurisë: Niveli "A", konfidencial.

12. Specialist i financës

12.1 Specialisti i financës përgjigjet për ndjekjen dhe zbatimin e politikave në fushën ekonomiko-financiare.

12.2 Specialisti i financës ka këto detyra*:*

a) Të menaxhojë burimet financiare dhe mirëmbajtjen e ambienteve të punës.

b) Të ndjekë marrëdhënien me degën e thesarit dhe të bëjë aktrakordimet përkatëse mujore e progresive me këtë institucion.

c) Të hartojë çdo muaj dokumentacionin e nevojshëm për pagesën e punonjësve për punën e kryer gjatë muajit.

ç) Të përpilojë evidencat statistikore të realizimit të numrit të punonjësve dhe të fondit të pagave dhe t'i dërgojë në instancat përkatëse.

d) Të kontabilizojë, pas kontrollit të dokumentacionit justifikues, të gjitha veprimet e hyrje-daljeve për çdo veprim të institucionit.

dh) Të ndjekë inventarizimin e të gjitha vlerave materiale e monetare, si dhe qarkullimin e këtyre vlerave brenda të gjitha hallkave të institucionit.

e) Të bëjë kontabilizimin e të gjitha të dhënave të institucionit dhe hedhjen në sistemin Alfa Platinum, pas konfirmimit në bashkërendim me shefin e sektorit të financës, për llogari të arkës, bankës, magazinës, e të gjitha veprimeve të tjera ekonomiko-financiare të institucionit.

ë) Të nxjerrë në kohë të dhënat për bilancin mujor/progresiv sipas ligjit mbi kontabilitetin dhe, në bashkëpunim me shefin e sektorit, të përgatitë bilancin vjetor të aktivitetit ekonomiko-financiar të institucionit.

12.3 Arsimimi, kualifikimi dhe eksperienca e specialistit të financës:

- Të ketë kryer arsimin e lartë, dega ekonomik, financë.
- Të ketë mbi 5 (pesë) vjet përvojë pune në administratën shtetërore në sektorët e financës.
- Të ketë aftësi dhe të zotërojë metodën e punës në grup.
- Të ketë kryer trajnimet bazë të nevojshme në fushën e ekonomisë.
- Të njohë një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze.
- Të njohë programet bazë të kompjuterit.

12.4 Shkalla e sigurisë: Niveli "A", konfidencial.

13. Sektori i sekretarisë, protokollit, arkivit

Përgjegjësi i sektorit

13.1 Përgjegjësi i sektorit të sekretarisë, protokollit, arkivit përgjigjet për ruajtjen, klasifikimin dhe ndarjen e dokumenteve sipas nivelit të klasifikimit dhe dërgimin e tyre në sektorët përkatës sipas adresimit të eprorëve.

13.2 Përgjegjësi i sektorit të sekretarisë, protokollit, arkivit kryen këto detyra:

a) Të administrojë, të ruajë dhe të përpunojë dokumentet që prodhohen në QNOD. Të menaxhojë korrespondencën, sipas udhëzimeve të eprorëve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

b) Të organizojë punën për evidentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, sipas rregullave dhe dispozitave ligjore në fuqi.

c) Të marrë masa për ruajtjen fizike të dokumenteve sekrete duke ndikuar për zbatimin e rregullave të ruajtjes së sekretit.

ç) Të mbajë në zarfe të mbyllura dhe të vulosura një kopje të çelësave të zyrave.

d) Të ruajë dhe të përdorë vulën zyrtare, sipas udhëzimeve në fuqi, dhe të mos e përdorë atë në dokumente të pamiratuara nga titullari i institucionit dhe, në mungesë, nga personi i autorizuar prej tij.

dh) Të klasifikojë materiale dokumentare për t'u arkivuar.

13.3 Arsimimi, kualifikimi dhe eksperienca e përgjegjësit të sektorit të sekretarisë, protokollit, arkivit:

- Të ketë kryer arsimin e lartë.
- Të ketë mbi 10 (dhjetë) vjet eksperiencë pune në administratën shtetërore në funksione të njëjta ose të ngjashme.
- Të ketë aftësi dhe të zotërojë metodën e punës në grup.
- Të ketë kryer kurse kualifikimi të sektorëve të administrimit të dokumenteve.
- Të njohë një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze.
- Të njohë programet bazë në kompjuter.

13.4 Shkalla e sigurisë: Niveli "B", sekret.

14. Specialist i sektorit të sekretarisë, protokollit, arkivit

14.1 Specialisti i sektorit të sekretarisë, protokollit, arkivit përgjigjet për miradministrimin, shumëfishimin, protokollimin, shpërndarjen dhe arkivimin e materialeve.

14.2 Specialisti i sektorit të sekretarisë, protokollit, arkivit ka këto detyra:

a) Të administrojë, të ruajë, të përpunojë dokumentacionin e ardhur dhe të prodhuar në QNOD.

b) Të printojë dhe të shumëfishojë materialet shkresore dhe dokumentet që prodhohen nga sektorët e ndryshëm të QNOD-së.

c) Të zbatojë kërkesat e ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror", dhe të ligjit nr. 9541, datë 22.5.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror"".

ç) Të evidentojë dhe të qarkullojë dokumentacionin e hyrë dhe të dalë nga sektorët e QNOD-së, sipas udhëzimeve të përgjegjësit të sektorit dhe legjislacionit në fuqi.

d) Të administrojë shumëfishimin dhe shpërndarjen e materialeve, udhëzimeve dhe rregulloreve të hartuara.

dh) Të arkivojë dhe të protokollojë materialet për të cilat ka përfunduar afati i përdorimit.

e) Të mbajë komunikimet me mediat dhe institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas udhëzimeve të drejtorit administrativ.

14.3 Arsimimi, kualifikimi dhe eksperienca e specialistit të sektorit të sekretarisë, protokollit, arkivit:

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë.
- Të ketë mbi 2 (dy) vjet përvojë pune në administratë.
- Të ketë aftësi dhe të zotërojë metodën e punës në grup.
- Të ketë kryer kurse kualifikimi të sektorëve të administrimit të dokumenteve.
- Të njohë një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze.
- Të njohë programet bazë në kompjuter.

14.4 Shkalla e sigurisë: Niveli "B", sekret.

15. Sektori i administratorëve të sallës operacionale

Administratori i sallës operacionale

15.1 Administratori i sallës operacionale përgjigjet për organizimin dhe menaxhimin e sallës operacionale për ndjekjen dhe zbatimin e detyrave funksionale të personelit.

15.2 Administratori i sallës operacionale kryen këto detyra:

a) Të menaxhojë, të drejtojë dhe të administrojë strukturat organizative në përbërje të sallës operacionale në mënyrë sa më efikase gjatë gjithë aktivitetit të tyre, si dhe të japë asistencë gjatë zhvillimit të operacioneve të kombinuara detare për ushtrimin e kontrollit të zbatimit të ligjit në det.

b) Të koordinojë dhe të drejtojë punën për planëzimin, organizimin dhe zbatimin e planeve operacionale, të përpunuara bashkërisht me koordinatorët institucionalë.

c) Të koordinojë dhe të drejtojë punën në bashkëpunim me koordinatorët institucionalë për të siguruar gatishmërinë e mjeteve lundruese dhe të sistemeve të komunikimit e vëzhgimit.

ç) Të koordinojë dhe të drejtojë punën për të siguruar gatishmërinë e personelit në sallën operacionale në QNOD.

d) Të njohë procedurat e punës dhe të kërkojë zbatimin e tyre nga personeli i sallës.

dh) Të përgatitë raportin ditor, me shkrim dhe në rrugë elektronike, në bashkëpunim me oficerët e shërbimit për aktivitetin e përditshëm.

e) Të koordinojë punën me sektorin e analizës, planifikimit dhe trajnimit dhe koordinatorët për trajnimin e personelit të sallës operacionale.

ë) Në një situatë të jashtëzakonshme, kur kërkohet pjesëmarrja e dy apo më shumë institucioneve në një operacion (operacion i kombinuar) dhe kur nuk arrihet konsensusi për marrjen e një vendimi të përbashkët nga

oficerët e shërbimit/oficerët civilë të turnit, analizon situatën dhe përcakton regjimin juridik të operacionit. Nëse e vlerëson të nevojshme i raporton drejtorit administrativ.

f) Të marrë pjesë në takimet e organizuara për operacionet detare dhe të përgatitë raporte që kanë të bëjnë me këto operacione.

g) Për çdo mangësi, gjatë koordinimit të punës dhe administrimit të sallës operacionale, të njoftojë koordinatorët institucionalë dhe drejtorin administrativ.

15.3 Arsimimi, kualifikimi dhe eksperienca e administratorit të sallës operacionale:

- Të ketë kryer arsimin e lartë.
- Të ketë mbi 10 (dhjetë) vjet eksperiencë pune.
- Të ketë aftësi dhe të zotërojë metodën e punës në grup.
- Të ketë kryer kurse kualifikimi në fushën e menaxhimit.
- Të njohë një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze.
- Të njohë programet bazë në kompjuter.

15.4 Shkalla e sigurisë: Niveli "B", sekret.

16. Koordinatorët institucionalë

Koordinatorët janë përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e planeve operacionale të përpunuara bashkërisht, të vlerësimeve të riskut, të rekomandimeve, planeve të trajnimit etj. Koordinatorët institucionalë caktohen nga institucionet përkatëse dhe i përfaqësojnë këto institucione gjatë planifikimit të përditshëm dhe afatgjatë operacional në QNOD. Ata janë përgjegjës dhe eprorë të drejtpërdrejtë për personelin e institucionit të tyre të përfaqësuar në QNOD. Ata varen nga institucioni përkatës dhe përgjigjen te drejtori administrativ për realizimin e misionit të QNOD-së. Koordinatorët institucionalë janë përgjegjësit kryesorë të institucionit që përfaqësojnë. Ata përgjigjen për menaxhimin dhe zbatimin e ligjshmërisë në hapësirën detare, si dhe mbikëqyrjen e personelit përkatës.

16.1 Koordinatorët institucionalë kanë përgjegjësi të përgjigjen për mirëfunksionimin e aseteve në dispozicion të QNOD-së, realizimin e detyrave nga personeli vartës, informimin e vazhdueshëm dhe në mënyrë periodike të eprorëve institucionalë dhe drejtorit administrativ për problematikat, arritjet dhe vështirësitë e hasura gjatë realizimit të operacioneve të kontrollit të zbatimit të ligjit në det.

16.2 Koordinatorët institucionalë kanë këto detyra:

a) Të planëzojnë, të organizojnë, të koordinojnë dhe të zbatojnë planet operacionale të QNOD-së të përpunuara bashkërisht.

b) Të koordinojnë dhe të planifikojnë përdorimin e integruar gjithëvjetor të mjeteve dhe të infrastrukturës përkatëse me institucionet e tjera pjesëmarrëse në QNOD.

c) Të zhvillojnë analiza për çdo situatë dhe të përgatitin raporte të përbashkëta midis tyre dhe qendrës.

ç) Të organizojnë punën për grumbullimin e informacionit për situatat detare dhe të kujdesen për garantimin e transmetimit efikas të tij në strukturat përkatëse.

d) Të përgatitin rekomandimet për nevojën e trajnimit të efektivave të QNOD-së për zhvillimin e operacioneve detare dhe t'i ndjekin me përparësi ato.

dh) Të përgatitin planet periodike dhe vjetore të detyrave për personelin në kuadrin e QNOD-së në përputhje me procedurat operacionale standarde të miratuara.

e) Të mbajnë lidhje të ngushta me njësitë vepruese (vartëse) përgjatë vijës bregdetare dhe hapësirës detare, me qëllim që të jenë të informuar (të përditësuar) për situatën aktuale për të dhënë dhe për të marrë informacion nga/dhe për personelin.

ë) Të marrin pjesë në takimet e organizuara për operacionet detare dhe të përgatitin raporte që kanë të bëjnë me këto operacione.

f) Të përgatitin planet dhe programet për trajnimin profesional në interes të realizimit me sukses të operacioneve të kombinuara detare të QNOD-së për personelin e institucionit përkatës.

16.3 Arsimimi, kualifikimi dhe eksperienca e koordinatorëve institucionalë:

- Të kenë kryer arsimin e lartë.
- Të kenë mbi 10 (dhjetë) vjet eksperiencë pune.
- Të kenë aftësi dhe të zotërojnë metodën e punës në grup.
- Të kenë kryer kurse kualifikimi në specialitetin e fushës që mbulojnë.
- Të njohin një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze.
- Të njohin programet bazë në kompjuter.

16.4 Shkalla e sigurisë: Niveli "B", sekret.

17. Oficerët e shërbimit/Oficerët civilë të turnit

Oficerët e shërbimit/oficerët civilë të turnit përfaqësojnë institucionet që kanë interesa në det dhe janë përgjegjës për ndjekjen dhe zhvillimin e operacioneve detare. Ata emërohen me urdhër të ministrit përkatës e varen nga koordinatori institucional dhe përgjigjen tek administratori i sallës operacionale e drejtori administrativ për zbatimin e detyrave e të procedurave të miratuara.

17.1 Oficerët e shërbimit/oficerët civilë të turnit kanë përgjegjësi të përgjigjen për vlerësimin e situatës detare, njohjen dhe përdorimin operacional të burimeve.

17.2 Oficerët e shërbimit/oficerët civilë të turnit kanë këto detyra*:*

a) Të përfaqësojnë institucionet përkatëse në QNOD në ndjekjen e situatës detare, vlerësimin e saj, organizimin e drejtimin e operacioneve sipas përkatësisë institucionale.

b) Të njohin dhe të zbatojnë dispozitat ligjore e nënligjore, kërkesat e rregulloreve, udhëzimet dhe urdhrat e veçantë për shërbimin në QNOD.

c) Të njohin mirë bregdetin shqiptar dhe karakteristikat e rajoneve kryesore detare, si dhe punën në hartat detare e përdorimin praktik të tyre nga ana operacionale.

ç) Të njohin detyrat funksionale dhe procedurat e radhën e punës, si dhe ndjekjen e operacioneve në përputhje me regjimet juridike të institucionit që përfaqësojnë.

d) Në varësi të situatave të skenarit detar dhe vlerësimit të regjimit juridik të operacionit përkatës, të koordinojnë punën ndërmjet tyre për realizimin me sukses të operacionit.

dh) Të ndjekin në vijimësi situatën duke bashkëpunuar e shkëmbyer informacion me Qendrën Operacionale Vlorë, Sarandë, Shëngjin, Flotiljes së Veriut, sallave operative të drejtorive rajonale të Policisë Kufitare dhe Migracionit Durrës e Vlorë, grupeve të gatshme të Shërbimit Doganor, shërbimeve të Inspektoratit të Peshkimit e Mjedisit në terren, duke dhënë detyra shtesë dhe duke marrë informacion të vazhdueshëm nga ata.

e) Të informojnë koordinatorin institucional dhe drejtorin administrativ për aktivitetet e kryera si dhe situatat e krijuara.

ë) Para marrjes së shërbimit, të njihen nga oficerët e shërbimit/oficerët civilë të turnit dorëzues për situatën në përgjithësi dhe atë detare në veçanti.

f) Të njihen dhe të ndjekin planin e lëvizjes së mjeteve lundruese në hapësirën detare.

g) Kur informohen nga mjetet lundruese për parregullsi të sistemit të sigurimit të lundrimit, të lajmërojnë menjëherë të gjitha institucionet që kryejnë veprimtari në det dhe komandantin e Shërbimit Hidrografik të Flotës Detare për të marrë masa për funksionimin e tyre.

gj) Në përfundim të çdo operacioni, të hartojnë një raport të detajuar i cili arkivohet në sekretarinë e QNOD-së.

h) Të dinë pikat e kontaktit dhe të kenë mundësi komunikimi për çdo rast të nevojshëm me drejtuesit e strukturave përgjegjëse të institucioneve pjesëmarrëse (Drejtorin e Departamentit të Policisë Kufitare dhe Migracionit, Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave, Komandantin e Forcave Detare, Drejtorin e Kontrollit për Mjedisin).

i) Të dinë në çdo kohë vendndodhjen e koordinatorëve institucionalë.

17.3 Arsimimi, kualifikimi dhe eksperienca e oficerëve të shërbimit/oficerëve civilë të turnit:

- Të kenë mbaruar arsimin e lartë.
- Të kenë eksperiencë pune mbi 3 (tre) vjet.
- Të kenë aftësi dhe të zotërojnë metodën e punës në grup.
- Të kenë kryer kurse kualifikimi në specialitetin e fushës që mbulojnë.
- Të njohin një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze.
- Të njohin programet bazë në kompjuter.

17.4 Shkalla e sigurisë*:* Niveli "B", sekret.

18. Operatorët e sistemit

18.1 Operatorët e sistemit kanë përgjegjësi të përgjigjen për ndjekjen dhe vlerësimin e situatës detare dhe informimin në kohë të saj.

18.2 Operatorët e sistemit kanë këto detyra:

a) Të kontrollojnë hapësirën detare shqiptare, të vlerësojnë objektet e dyshimta, si dhe të komunikojnë me të gjitha mjetet detare.

b) Të njohin mirë bregdetin shqiptar dhe karakteristikat e tij.

c) Të njohin rregullat e punës në hartat detare dhe përdorimin praktik të tyre nga ana operacionale.

ç) Të njohin rregullat e komunikimit në det dhe të komandimit operacional.

d) Të njohin karakteristikat e mjeteve të ndryshme detare.

dh) Të kenë informacion të plotë mbi planin e lëvizjes së anijeve në hapësirën detare dhe të ndjekin në monitorët e sistemit SIVHD, SMART dhe Blue-Box situatën detare në çdo kohë.

e) Të vënë në dijeni oficerët e shërbimit /oficerët civilë të turnit dhe administratorin e sallës së QNOD-së për dyshimet apo objekte që duhet të jenë nën kontroll.

ë) Në situata të veçanta, me miratim të oficerit të shërbimit/oficerit civil të turnit dhe administratorit të sallës, të bëjnë kopjimin e situatës reale në det për objekte të dyshuara apo për çdo problem operacional.

f) Të sigurojnë ndërlidhje të pandërprerë me radio dhe telefon me të gjitha pikat repetitive dhe radarët për marrje e shkëmbim informacioni të nevojshëm.

g) Të kryejnë koordinimin e sektorëve të radarëve, sipas qendrave operacionale në rastet që e kërkon situata.

18.3 Arsimimi, kualifikimi dhe eksperienca e operatorëve të sistemit:

- Të kenë mbaruar arsimin e mesëm ose profesional.
- Të kenë eksperiencë pune mbi 5 (pesë) vjet.
- Të kenë aftësi dhe të zotërojnë metodën e punës në grup.
- Të kenë kryer kurse kualifikimi në specialitetin e fushës që mbulojnë.
- Të njohin një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze.
- Të njohin programet bazë në kompjuter.

18.4 Shkalla e sigurisë: Niveli "B", sekret.".

II. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 587, datë 1.7.2015

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR PROKURORINË E PËRGJITHSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Prokurorisë së Përgjithshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, në kategorinë e shpenzimeve operative, i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh për mbulimin e rritjes së pagave të punonjësve të shërbimit privat të sigurisë fizike.

2. Prokurorisë së Përgjithshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, në kategorinë e shpenzimeve korrente, i shtohet fondi prej 19 000 000 (nëntëmbëdhjetë milionë) lekësh për mirëmbajtjen e sistemit informatik të saj dhe aplikacioneve të konfiguruara në këtë sistem.

3. Efekti financiar, i parashikuar në pikat 1 e 2, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Prokuroria e Përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 588, datë 1.7.2015

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE TE MINISTRIA E FINANCAVE, PËR DEGËN E THESARIT GJIROKASTËR, TË NJË AMBIENTI NË PRONËN NR. 4/183+1-12, NË ZONËN KADASTRALE NR. 8542, ME VENDNDODHJE NË ADRESËN "LAGJJA VAROSH", NË QYTETIN E GJIROKASTRËS, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 513, DATË 15.8.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË FINANCAVE PËR AGJENCINË E TRAJTIMIT TË KREDIVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "c", të nenit 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Agjencia e Trajtimit të Kredive te Ministria e Financave, për Degën e Thesarit Gjirokastër, të një ambienti me sipërfaqe 61,2 (gjashtëdhjetë e një presje dy) m^2, me numër pasurie nr. 4/183+1-12, në zonën kadastrale nr. 8542, me vendndodhje në adresën "Lagjja Varosh", në qytetin e Gjirokastrës, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ambienti me sipërfaqe 61,2 (gjashtëdhjetë e një presje dy) m^2, në pronën me numër pasurie nr. 4/183+1-12, në zonën kadastrale nr. 8542, me vendndodhje në adresën "Lagjja Varosh", Gjirokastër, të hiqet nga lista e inventarit, e miratuar me vendimin nr. 513, datë 15.8.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Financave për Agjencinë e Trajtimit të Kredive".

3. Ngarkohen Agjencia e Trajtimit të Kredive, Ministria e Financave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

20/03/13

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË

PËR VËRTETIM PRONËSIE 646042

Zyra e Regjistrimit GJIROKASTER Zona Kadastrale Nr. 8542

Numri i Pasurisë 4/183 +1-12 Volumi 2 Faqe 61

Adresa e Pasurisë L. VARROSH

Lloji i Pasurisë APARTAMENT

Sipërfaqja Totale 61,2 M²

Nga kjo : Sa Truall – Nga kjo : Sa Ndërtesa 61,2 M²

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes – %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
AGJENCIA E TRAJTIMIT TE KREDINE			1	GJIROKASTER

- është pronar i PJ. NR. 4/183/1-12
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart –
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi –
- kufizimet e pasurisë janë : V HAPESIRE, L AP. BANIMI, J AP. BANIMI, P HAPESIRE

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 19.09.2012 **Nr.** 227

Data e lëshimit të çertifikatës 18.01.2013

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUEJTSHME

GJIROKASTER

REGJISTRUESI

Ing.DHIMITRI KRISTIDHI

A.INDETIFIKIMI I PASURISE
ZONA KADASTRALE 8542 NR I PASURISE 4/183 11-12 VOL____ FQ____
INDEKSI I HARTES 67-1-7 SHKALLA 1=500
ADRESA E PASURISE : Rrethi GJIROKASTER Q/F GJIROKASTER
Rr/L MIZI BANKE VARROSH. P/G_____ SH 1 K 2 AP 12

B.KUFIZIMET
V. Hapesire
L. AP BANIMI
J. AP BANIMI
P. HAPESIRE.

C.PRONARI
AGJENCIA E TRAJTIMIT TE KREDIVE

SIPERFAQJA – m²
NDERTUAR 61,2 m²

D.Data: 16/01/2013, Ora: 10⁰⁰.

Hartograf : Ing. ALEKSANDER ZHULATI

0000000 00471

V. K. M. Nr. 519, Datë 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol. 2, Fq. 61

IONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

--> Vijon nga: Vol.____, Fq.____

a Kadastrale: 8542 NR. i PASURISE: 4/183 +1-12

Vijon në: Vol.____, Fq.____ deri në: Vol.____, Fq.____-->

si i Hartës: G7- Y-7 I-I

PERFUNDIMTARE (data):__/__/__

esa e pasurisë : Rrethi GJIROKASTER Q/F GJIROKASTER

Rr/L VARROSH P/G MBI BANKE Sh 1 K 2 Ap. 12

Përshkrim i Veçantë

REF OKH
VKM. NR. 513. DT. 15.08. 2002

IONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Pasurisë : APARTAMENT Brenda V.K.N. : Jo ---> Po, Ref :

ale e Pasurisë	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë
61,2 m² OKH	1.____ m² Ref____	1.____ m² Ref____
____ m²	2.____ m² Ref____	2.____ m² Ref____
____ m²	3.____ m² Ref____	3.____ m² Ref____
____ m²	4.____ m² Ref____	4.____ m² Ref____

Për pjesën e përbashkët:

PALLAT

Kuota e Pjesëmarrjes: ____ %

Nr. i Pasurisë (Pallat): 4/183

Vol. 1 Fq. ____

IONI I PRONESISE

Data Regjistrim	Emri Atësia Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
16.01.2013	AGJENCIA TRASHTIMIT TE KREDIVE (ATK) GJIROK.			L. VARROSH GJIROK.		18.01.2013	V.KM.	

ona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqësues i familjes; B - bashkëpronar (%)

D - SEKSIONI I QIRAVE, NË PËRDORIM, MARRËVESHJEVE KUFIZIMEVE, SERVITUTAVE DHE INTERESAVE TË TJERA

Nr. Dok	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lëshimit të Certifikatës	Shënime	Firma

E- SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TË GJYKATËS, KUFIZIMEVE, etj

Nr. Dok	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lëshimit të Çertifikatës	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME Gjirokastër
Adresa: Pranë Këshillit të Qarkut Tel/Fax: ++ 355 84 65374

Gjirokastër me 16 / 02 / 2015

SHËNIM: Kjo kopje kartelë në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tonë.
Në Regjistrin Vol. 2 Faqe 61 Zona Kadastrale 8542

REGJISTRUES

1:500
4/173
4/171
4/172
4/174
4/176
4/177
4/175
4/182
4/181
4/184
4/183
4/164
4/165
4/167
4/166
8/28
8/29
8/30
8/31
8/32
8/33
8/34
8/35
8/36
8/37
8/42
8/43
8/44
8/46
8/38
8/39
8/40
8/14
8/41
8/142
7/38
7/37
7/39
7/40
7/42
7/41
7/43
10/8
10/7
10/9
10/5

PLAN RILEVIMI



VENDIM
Nr. 589, datë 1.7.2015

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 2, 15, pika 3, dhe 18, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e personave të shpallur sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar, pas shkronjës "D", shtohet shkronja "DH" me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

"DH. Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë të organizatave terroriste.

NIKOLAOS MAZIOTIS - shtetas grek;

CHRISTODOULOS XIROS - shtetas grek.".

2. Ngarkohen autoritetet përgjegjëse, të përcaktuara në nenin 7, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 590, datë 1.7.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 41, DATË 21.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 378, DATË 12.8.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PËRFAQËSUESIT TË PRONARIT PËR DISA OBJEKTE, PRONË PUBLIKE, ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE", TË NDRYSHUAR, DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 127, DATË 2.2.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË MALIQ, TË QARKUT TË KORÇËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, të neneve 3, 8, 13 dhe 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të nenit 8/a, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr. 51, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. E drejta e përfaqësuesit të pronarit shtet për shoqërinë "Kombinati i Sheqerit" sh.a., Maliq, kalohet nga Bashkia Maliq te Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.".

2. Revokohet e drejta e kalimit të pronësisë Bashkisë Maliq dhe hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 127, datë 2.2.2009, të Këshillit të

Ministrave, pronat me numër rendor 52-72, 95-97, 100, 104, 105, 287, 288, 575.

3. Pronat, sipas pikës 2, të këtij vendimi, të kalojnë në pronësi të "Kombinatit të Sheqerit" sh.a. Maliq.

4. Zyra Regjistrimit të Pasurive së Paluajtshme të kryejë regjistrimin e pasurive, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, në pronësi të shoqërisë "Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq.

5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Bashkia Maliq dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. Formular për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)
LISTA E PASURIVE TË PALUAJTSHME QË KALOJNË NË PRONËSI TË "KOMBINATI I SHEQERIT" SHA MALIQ

Nr. rend.	A				B				C			
	Zona kadastrale	Indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës	Adresa	Sip. e truallit (m²)	Sip. ndërtese (m²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit shtet	Institucioni/enti ku do të regjistrohet statusi juridik	Të dhëna të tjera Pronësia ekzistuese sipas kartelës së lëshuar nga ZVRP Korçë
1	2		3	4	5		6	7	8	9	10	11
1	1667	K-34-114(215-c)	1456	truall	Shesh	Fshat Maliq	6,280		aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Shtet
2	1667	K-34-114(215-c)	1455 & 1457	truall	Sheshi i Dampave dhe dampat	Fshat Maliq	16,000		aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Shtet dhe Min. Financave
3	3553	K-34-114(215-c)	283	rezervuar	Rezervuar alkooli	Symiz		59	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Min. e Financave
4	3553	K-34-114(215-c)	280	rezervuar	Rezervuar alkooli	Symiz		78.5	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Min. e Financave
5	3553	K-34-114(215-c)	279	rezervuar	Rezervuar alkooli	Symiz		78.5	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Min. e Financave
6	3553	K-34-114(215-c)	278	truall	Truall	Symiz	2,852		aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Shtet
7	3553	K-34-114(215-c)	286	rezervuar	Rezervuar alkooli	Symiz		59	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Min. e Financave
8	3553	K-34-114(215-c)	285	rezervuar	Rezervuar alkooli	Symiz		59	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Min. e Financave
9	3553	K-34-114(215-c)	284	rezervuar	Rezervuar alkooli	Symiz		59	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Min. e Financave
10	2573	Ma-D-4	3/350	truall	Truall	Maliq	8,234		aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Shtet
11	2573	Ma-c-4	3/301	rezervuar	Gropa e Bërsive	Maliq		8,144	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
12	2573	Ko-Maliq-C-5	1/198	rezervuar	Për thithjen e ujit	Maliq		760	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
13	2573	Ko-Maliq-C-5	1/102	truall	Truall	Maliq	140		aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
14	2573	Ko-Maliq-C-4	1/253	ndërtesë	Magazina e thasëve	Maliq		2,554	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
15	2573	Ko-Maliq-C-3	1/252	ndërtesë	Magazina e thasëve	Maliq		274	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
16	2573	K-Maliq-C3+C4	1/251	truall	Truall	Maliq	5,779		aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
17	2573	Ko-Maliq-C-4	1/234	truall	Truall	Maliq	330		aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
18	2573	Ma-c-4	1/433	truall	Truall	Maliq	53,671		aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
19	2573	Ko-Maliq-C-4	1/233	ndërtesë	Nënstacion elektrik	Maliq		99	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
20	2573	Ko-Maliq-C-4	1/249	ndërtesë	Infermieria	Maliq		114	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
21	2573	Ko-Maliq-C-4	1/239	ndërtesë	Fabrika e Majasë	Maliq		264	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
22	2573	Ko-Maliq-C-4	1/231	ndërtesë	Fabrika e re Sheqerit	Maliq		1,410	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
23	2573	Ko-Maliq-C-4	1/237	ndërtesë	Depo sheqeri	Maliq		2,025	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
24	2573	Ko-Maliq-C-4	1/240	ndërtesë	Furrë e Gëlqeres	Maliq		633	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
25	2573	Ko-Maliq-C-4	1/245	ndërtesë	Fabrika e Niseshtesë	Maliq		1,288	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
26	2573	Ko-Maliq-C-4	1/227	ndërtesë	Fabrika e Bërsive	Maliq		1,127	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
27	2573	Ko-Maliq-C-4	1/229	ndërtesë	Oficina e Bërsive	Maliq		721.5	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
28	2573	Ko-Maliq-C-4	1/226	ndërtesë	Kapanon Qymyri	Maliq		960	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
29	2573	Ko-Maliq-C-4	1/230	ndërtesë	Magazina Sheqerit, Fabrika e vjetër	Maliq		2,844	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
30	2573	Ko-Maliq-cc4	1/250	ndërtesë	Oficina mekanike	Maliq		1,165.5	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
31	2573	Ko-Maliq_c-4	1/248	ndërtesë	Administrata	Maliq		290.6	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
32	2573	Ko- Maliq -c-4	1/247	ndërtesë	Laboratori + Mensa	Maliq		422.4	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
33	2573	Ko-Malqi_c-4	1/246	ndërtesë	Vend Roje	Maliq		42	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
34	2573	Ko-Maliq-C-4	1/232	ndërtesë	Fabrika e Vjetër e Sheqerit	Maliq		4,147	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
35	2573	Ko- Maliq -D-4	3/353	truall	Truall dhe rrugë	Maliq	29,400		aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
36	2573	Ko-Maliq-D-4	3/352	vaska	Vaskat e Panxharit	Maliq		22,940	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	Bashkia Maliq
37	3221			truall	Qendër Grumbullimi	Rembec	12,480		aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	
38	1310			truall	Qendër Grumbullimi	Bulgarec	6,300		aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	
39	1310			ndërtese	Peshore	Bulgarec		30	aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	
40	1355		45	truall	Qendër Grumbullimi	Proger	9,680		aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	
41	1321			truall	Gurore	Burimas	19,260		aktivitet ekonomik	MZHETTS	"Kombinati i Sheqerit" sh.a. Maliq	

VENDIM
Nr. 592, datë 1.7.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 283, DATË 1.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E TIPAVE, RREGULLAVE, KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE PËR PRODHIMIN, RUAJTJEN DHE PËRPUNIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE BLEGTORALE, NË TOKË BUJQËSORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11/1, pikat 5/2 e 5/4, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës", të ndryshuar, dhe të nenit 8, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të kreut IV, të vendimit nr. 283, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, fjalët "... por jo më vonë se 3 muaj ..." zëvendësohen me " ... por jo më vonë se 6 muaj ...".

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Zhvillimit Urban për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 593, datë 1.7.2015

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NDËRMJET PROGRAMEVE TË MIRATUARA NË BUXHETIN E VITIT 2015, PËR MINISTRINË E KULTURËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 160, datë 27.4.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve të miratuara në buxhetin e vitit 2015, për Ministrinë e Kulturës, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor (08230) "Arti dhe kultura", në llogarinë "Investime", (231) të zbritet fondi prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh.

b) Në programin buxhetor (01110), "Planifikim, menaxhim, administrim", në llogarinë "Investime", (231) të zbritet fondi prej 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekësh.

c) Në programin buxhetor (08220), "Trashëgimi kulturore dhe muzetë", të shtohet, në zërin "Investime", fondi prej 8 500 000 (tetë milionë e pesëqind mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve për shpronësimin, për interes publik, të pasurisë, pronë private, që preket nga zbatimi i projektit "Rehabilitimi i Amfiteatrit të Durrësit".

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 594, datë 1.7.2015

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SËMUNDJEVE PROFESIONALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 25, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së sëmundjeve profesionale, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr. 396, datë 28.6.2007, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e sëmundjeve profesionale", shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 shtator 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA I
LISTA
E SËMUNDJEVE PROFESIONALE

Sëmundjet e përmendura në këtë listë konsiderohen sëmundje profesionale kur lidhen direkt me profesionin e pacientit dhe ekspozimin në vendin e punës.

1	**Sëmundjet e shkaktuara nga agjentët e mëposhtëm kimikë:**
	Akrilonitril
	Arsenik ose përbërës të tij
	Berilium (glucinium) ose përbërës të tij
	Monoksid karboni
	Oksiklorid karboni
	Acid hidrocianik
	Cianide dhe përbërës të tyre
	Izocianate
	Kadmium ose përbërës të tij
	Krom ose përbërës të tij
	Mërkuri ose përbërës të tij
	Mangan ose përbërës të tij
	Acid nitrik
	Okside të azotit
	Amoniak
	Nikel ose përbërës të tij
	Fosfor ose përbërës të tij
	Plumb ose përbërës të tij
	Okside të sulfurit
	Acid sulfurik
	Disulfid karboni
	Vanadium ose përbërës të tij
	Klor brom
	Jod
	Fluor ose përbërës të tij
	Hidrokarbure aliciklike ose alifatike të përftuar nga esenca e naftës ose nafta
	Derivate të halogjenizuara të hidrokarbureve alfatike ose aliciklike
	Butil, metil dhe alkool izopropil
	Glikol etileni, glikol dietileni, 1,4-butanediol dhe derivate azotikë të glikoleve dhe glicerolit
	Eter metili, eter etili, eter izopropili, eter vinili, eter dikloroizopropili, guaiakol, eter metili dhe eter etili i glikolit të etilenit
	Aceton, kloroaceton, bromoaceton, hegzafluoroaceton, keton etil metili, keton n-butil metili
	Keton izobutil metili, alkool diacetoni, oksid mesitili, 2-metilciklohexhanon
	Estere organofosforike
	Acide organike formaldehide
	Derivate azotikë alifatikë
	Benzen ose homologë të tij (homologët e benzenit përcaktohen nga formula: CnH2n-6)
	Naftalinë ose homologë të naftalinës (homologët e naftalinës përcaktohen nga formula: CnH2n-12)
	Vinilbenzen dhe divinilbenzen
	Derivate të halogjenizuar të hidrokarbureve aromatike
	Fenol ose homologë apo derivatet të halogjenizuar të tyre
	Naftole ose homologë apo derivate të halogjenizuar të tyre
	Derivate të halogjenizuar të oksideve të alkilarilit
	Derivate të halogjenizuar të sulfonateve të alkilarilit
	Benzokuinone
	Amina aromatike apo hidrazinat aromatike apo derivate të halogjenizuar, fenolike, nitrati apo sulfati të tyre
	Amina alfatike dhe derivate të halogjenizuar të tyre
	Derivate nitrati të hidrokarbureve aromatike
	Derivate nitrati të fenolëve ose homologëve të tyre
	Antimon dhe derivate të tij
	Estere të acidit nitrik

	Sulfit hidrogjeni
	Encefalopatitë për shkak të tretësve organikë që nuk vijnë nën rubrika të tjera
	Polineuropatitë për shkak të tretësve organikë që nuk vijnë nën rubrika të tjera
2	**Sëmundjet e lëkurës, të shkaktuara nga substancat dhe agjentët e papërfshirë në rubrikat e tjera:**
	Sëmundjet e lëkurës dhe tumoret e lëkurës të shkaktuara nga:
	Bloza
	Zifti
	Bitumi
	Katrani
	Antraceni ose përbërës të tij
	Vajrat minerale dhe vajrat e tjera
	Parafina bruto
	Karbazoli ose përbërës të tij
	Nënproduktet e distilimit të qymyrit
	Sëmundjet profesionale të lëkurës të shkaktuara nga alergji të njohura shkencërisht - substanca provokuese ose irrituese të papërfshira në rubrikat e tjera
3	**Sëmundjet e shkaktuara nga inhalacioni i substancave dhe agjentëve të papërfshirë në rubrikat e tjera:**
	Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes dhe tumoret:
	Silikoza
	Silikoza e kombinuar me tuberkulozin pulmonar
	Asbestoza
	Mezotelioma e ndjekur nga inhalacioni i pluhurit të asbestit
	Pneumokonioza e shkaktuar nga pluhurat e silikateve
	Komplikimet e asbestit në formën e tumorit bronkial
	Sëmundjet bronko-pulmonare të shkaktuara nga pluhurat e metaleve të shkrira
	Alveolitet alergjike ekstrinseke
	Sëmundjet e mushkërive të shkaktuara nga inhalacioni i pluhurave dhe fibrave të pambukut, linit, kërpit, juta, sizali dhe gëzhuta
	Sëmundjet respiratore të shkaktuara nga inhalacioni i pluhurit të kobaltit, kallajit, bariumit dhe grafitit
	Sideroza
	Sëmundjet kancerogjene të rrugëve të sipërme respiratore të shkaktuara nga pluhuri i drurit
	Astma alergjike të shkaktuara nga inhalacioni i substancave të njohura vazhdimisht si shkaktare të alergjive dhe që lidhen me llojin e punës
	Rinititi alergjik i shkaktuar nga inhalacioni i substancave të njohura vazhdimisht si shkaktare të alergjive dhe që lidhen me llojin e punës
	Sëmundje fibrotike të pleurës, me kufizim të frymëmarrjes shkaktuar nga asbesti
	Bronshiti apo emfizema obstruktive kronike te minatorët që punojnë në minierat e nëndheshme të qymyrit
	Kanceri i mushkërisë mbas inhalacionit të pluhurit të asbestit
	Sëmundje bronko-pulmonare të shkaktuara nga pluhurat ose gazrat nga alumini ose përbërës të tij
	Sëmundje bronko-pulmonare të shkaktuara nga pluhurat
4	**Sëmundjet infektive dhe parazitare:**
	Sëmundjet infektive dhe parazitare që u transmetohen njerëzve nëpërmjet kafshëve apo mbetjeve të kafshëve:
	Tetanozi
	Bruceloza
	Hepatiti viral
	Tuberkulozi
	Amebiazi
	Sëmundje të tjera infektive të shkaktuara nga puna në parandalimin e sëmundjeve, qendrat shëndetësore, asistenca në shtëpi dhe aktivitete të tjera të ngjashme, për të cilat është provuar një rrezik infektimi
5	**Sëmundjet e shkaktuara nga agjentët e mëposhtëm fizikë:**
	Katarakte të shkaktuara nga rrezatimi i nxehtësisë
	Sëmundjet konjuktivale që vijnë nga ekspozimi ndaj rrezatimit ultravjollcë
	Hipoakusis apo humbja e dëgjimit e shkaktuar nga zhurma
	Sëmundjet e shkaktuara nga kompresioni apo dekompresioni atmosferik
	Sëmundjet osteoartikulare të duarve dhe kyçeve të duarve të shkaktuara nga dridhja mekanike
	Sëmundjet angioneurotike të shkaktuara nga dridhja mekanike
	Sëmundje që manifestohen me edema të indeve periartikulare për shkak të presionit
	Bursit prepatelar dhe subpatelar

	Bursit olekranon
	Bursiti i shpatullave
	Sëmundje për shkak të lodhjes të këllëfëve të tendinave
	Sëmundje për shkak të lodhjes së peritendineumit
	Sëmundje për shkak të lodhjes së insertimeve muskulore dhe tendinoze
	Lezione të meniskut nga periudhat e zgjatura të punës në pozicion të gjunjëzuar ose në bisht
	Paralizë e nervave për shkak të presionit
	Sindroma e tunelit karpal
	Nistagamusi i minatorit
	Sëmundjet e shkaktuara nga rrezatimi jonizues

VENDIM
Nr. 595, datë 1.7.2015

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT NGA TOKË BUJQËSORE NË TOKË TRUALL DHE VËNIEN NË DISPOZICION TË PASURIVE PËR NDËRTIMIN E SHTËPIVE DHE INFRASTRUKTURËS SË NEVOJSHME PËR SISTEMIMIN E PERSONAVE TË PREKUR NGA NDËRTIMI I HEC-it TË BANJËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10083, datë 23.2.2009, "Për miratimin e kontratës së koncesionit, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues, dhe EVN AG, Statkraft AS e Devoll Hydropower sh.a., si bashkëkoncesionarë për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll, në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit nga tokë bujqësore në tokë truall të sipërfaqes prej 1 850 (një mijë e tetëqind e pesëdhjetë) m^2, sipas lidhjes 1 dhe hartave përkatëse, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Sipërfaqja e tokës së përcaktuar në lidhjet 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij vendimi, vendoset në dispozicion të shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a., për ndërtimin e shtëpive e të infrastrukturës përkatëse (rrugë), në përputhje me dokumentet e planifikimit të territorit. Ndërtimi i shtëpive dhe i infrastrukturës përkatëse është në funksion të sistemimit të personave të prekur nga HEC-i i Banjës, sipas kushteve të programit social të marrë përsipër nga shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a., në kuadër të zbatimit të projektit hidroenergjetik Devoll. Kostot për ndërtimin e shtëpive e të infrastrukturës përkatëse (rrugë) përballohen nga shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a., në përputhje me kushtet e marrëveshjeve individuale, të nënshkruara me familjet që janë pjesë e kësaj skeme.

3. Lista e familjeve, që do të përfitojnë shtëpi të ndërtuara sipas programit social që do të zbatohet nga shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a., dhe të dhënat për pasurinë ku do të ndërtohen këto shtëpi përcaktohen në lidhjen 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të Qarkut Elbasan të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimet e kategorisë së resursit nga tokë bujqësore në tokë urbane (truall) për sipërfaqen prej 1 850 (një mijë e tetëqind e pesëdhjetë) m^2, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Çdo vendim i Këshillit të Ministrave apo akt tjetër administrativ, që bie në kundërshtim plotësisht ose pjesërisht me këtë vendim, të ndryshohet ose të shfuqizohet.

6. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gramsh dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan të bëjnë ndryshimin e llojit të pasurive nga tokë bujqësore në tokë truall në certifikatat e pasurive, sipas të dhënave për pasurinë, të përcaktuara në lidhjet 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij vendimi. Kostot në lidhje me regjistrimin e pasurisë dhe objekteve që do të ndërtohen, përballohen nga

shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a.

7. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gramsh dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan, për pronat në lidhjet 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij vendimi, të bëjnë shënimin përkatës në kartelën e këtyre pronave, ku të shënojnë "Vënie në dispozicion për ndërtimin e shtëpive/banesave sociale dhe infrastrukturës përkatëse në kuadër të programeve sociale të shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a., në funksion të masave zbutëse minimizuese sociale, në kuadër të ndërtimit të projektit hidroenergjetik Devoll. Çdo kosto në lidhje me shënimin përkatës në kartelë do të përballohet nga shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a.

8. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe njësitë e qeverisjes vendore, ku do të kryhen ndërtimet përkatëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja 1 – Tokë Arë (kategoria V-X):

Komuna	Fshati	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Pronari	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe (m²)	Kategoria e tokës bujqësore	Koment ZVRPP Gramsh	Truall i kërkuar (m²)	Tokë e kërkuar për infrastrukture publike (rrugë)
Pishaj	Cingar i Poshtem	3262	48/68	Shteti	Are	1500	8		1050	300
Sult	Dushk	1580	226/6	Shteti	Are	106160	5		350	150
Total									**1400**	**450**

Lidhja 2 – Tokë në kategori tjetër:

Komuna	Fshati	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Pronari	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe (m²)	Kategoria e tokës bujqësore	Koment ZVRPP Gramsh	Truall i kërkuar (m²)	Toke e kërkuar për infrastrukturë publike (rrugë)
Kodovjat	Kodovjat	2188	156/10	Shteti	Shkëmbore	11776	E pakategorizuar		350	100
Pishaj	Qerret	3103	122/2	Shteti	Eroduar	7200	E pakategorizuar		2450	500
Pishaj	Drize	1556	142/1	Shteti	Truall	472	E pakategorizuar	21.03.2000 – Kufizim – Pasuria nr. 142/1	472	
Pishaj	Drize	1556	142/4	Shteti	Truall	5440	E pakategorizuar		228	350
Gramsh	Gramsh	1842	7/42	Shteti	Truall	6731.1	E pakategorizuar	Me VKM nr. 431, datë 11.7.2007	700	40
Total									**4200**	**1050**

Lidhja nr. 3 – Të dhënat për pasuritë:

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Komuna/ Bashkia	Fshati	Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Pronari	Lloji i pasurisë	Persona sipas certifikatës familjare	Persona total sipas inventarit (te deklaruara nga vete familjaret)	Persona qe jetojnë ne shtëpi	Persona qe jetojnë përkohësisht (student, emigrante, kujdestare etj.)
1	Andon	Selami	Dhëmbi	Kodovjat	Kodovjat	2188	156/10	Shtet	Shkëmbore	4	4	4	0
2	Shefki	Mersin	Çarçiu	Pishaj	Drize	1556	142/1; 142/4	Shtet	Truall	4	4	0	4
3	Hyqmet	Tefik	Tafa	Sult	Dushk	1580	222/6	Shtet	Are	4	5	1	4
4	Ismail	Shaip	Jança	Pishaj	Cingar i Poshtem	3262	48/68	Shtet	Are	3	9	9	0
5	Selim	Arif	Buzdra	Pishaj	Qerret	3103	122/2	Shtet	Eroduar	4	4	2	2
6	Qamil	Mustafa	Tafa	Pishaj	Qerret	3103	122/2	Shtet	Eroduar	6	6	4	2
7	Flamur	Sadik	Tërvoli	Pishaj	Qerret	3103	122/2	Shtet	Eroduar	3	3	3	0
8	Xhaferr	Hamit	Kullolli	Pishaj	Qerret	3103	122/2	Shtet	Eroduar	4	2	2	0
9	Ramadan	Liko	Baloshi	Pishaj	Qerret	3103	122/2	Shtet	Eroduar	2	7	5	2
10	Xhezare	Shaban	Tafa	Pishaj	Qerret	3103	122/2	Shtet	Eroduar	5	6	0	6
11	Samit	Ali	Kryemadhi	Pishaj	Qerret	3103	122/2	Shtet	Eroduar	4	5	0	5
12	Hekuran	Arif	Llapushi	Gramsh	Gramsh	1842	7/42	Shtet	Truall	3	6	0	6
13	Ismail	Sadik	Qyra	Gramsh	Gramsh	1842	7/42	Shtet	Truall	10	7	7	0
14	Kudret	Hekuran	Çarçiu	Pishaj	Drize	1556	142/1; 142/4	Shtet	Truall	5	5	5	0
15	Garip	Hajdar	Zogu	Pishaj	Cingar i Poshtem	3262	48/68	Shtet	Are	6	9	3	6

VENDIM
Nr. 597, datë 1.7.2015

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE KËRKESAVE TË HOLLËSISHME PËR LIDHJEN E MARRËVESHJEVE VULLNETARE, NDËRMJET ORGANIZATAVE DHE GRUPEVE QË PËRFAQËSOJNË INTERESA TË CAKTUARA, GRUPEVE TË OPERATORËVE OSE OPERATORËVE INDIVIDUALË ME AUTORITETET PËRKATËSE, PËR REALIZIMIN E NJË NIVELI MË TË LARTË MBROJTJEJE, SESA AI I PËRCAKTUAR NË LEGJISLACIONIN E POSAÇËM, PËR NJË PËRBËRËS MJEDISOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 57, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e procedurave dhe kërkesave të hollësishme për lidhjen e marrëveshjeve vullnetare, ndërmjet organizatave dhe grupeve që përfaqësojnë interesa të caktuara, grupeve të operatorëve ose operatorëve individualë me autoritetet përkatëse, nëpërmjet të cilave ata angazhohen për realizimin e një niveli më të lartë mbrojtjeje të mjedisit, sesa ai i përcaktuar në legjislacionin e posaçëm, për një përbërës mjedisor.

2. Marrëveshjet vullnetare lidhen ndërmjet ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe:

a) organizatave dhe grupeve që përfaqësojnë interesa të caktuara;

b) grupeve të operatorëve ose operatorëve individualë.

3. Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me ato të përcaktuara në ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, ndërsa termi "Kërkuesi" nënkupton palët e përmendura në pikën 2, të këtij vendimi.

4. Kërkuesi, i cili propozon të lidhë një marrëveshje vullnetare, duhet të depozitojë kërkesën e tij pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin, në cilësinë e autoritetit përkatës.

5. Kërkesa me shkrim, për lidhjen e marrëveshjes vullnetare, duhet të shoqërohet me dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna të përgjithshme të kërkuesit: emri i personit/ave fizik/juridik, adresa, ekstrakti i QKR-së, personi i kontaktit, kopje të të gjitha lejeve, licencave, autorizimeve dhe vendimeve me të cilat është i pajisur;

b) Relacion të hollësishëm lidhur me projektidenë që ai kërkon të zhvillojë për mbrojtjen e një ose më shumë përbërësve të mjedisit, duke argumentuar që kjo nismë nuk cenon aktivitetin, brenda përcaktimeve të akteve ligjore në fuqi, të organizatave dhe operatorëve të tjerë, si dhe ku të sqarohen arsyet e kërkesës për lidhjen e marrëveshjes vullnetare, mbi bazën e konsultimeve me grupet e caktuara të interesit, duke përfshirë qëllimin përfundimtar të projektidesë.

c) Kërkesat që do të përfshihen në marrëveshjen vullnetare;

ç) Çdo dokumentacion apo informacion tjetër që kërkuesi e gjykon të nevojshëm.

6. Ministria përgjegjëse për mjedisin, brenda 60 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës, duhet të:

a) shqyrtojë nëse dokumentacioni i dorëzuar është i plotë;

b) verifikojë nëse projektideja ka mundësi reale për përmbushjen e qëllimit përfundimtar, për mbrojtjen, në një nivel më të lartë të mjedisit sesa ai i përcaktuar në legjislacionin e posaçëm, për një ose më shumë përbërës të mjedisit.

c) njoftojë kërkuesin për plotësimin e dokumentacionit, nëse ka mangësi apo paqartësi.

7. Pas verifikimeve, ministria përgjegjëse për mjedisin njofton kërkuesin/t për të diskutuar për lidhjen e marrëveshjes dhe kushtet përkatëse që do të përfshihen në të. Në rast se ministria konstaton arsye ligjore dhe teknike që nuk përmbushin qëllimin përfundimtar të marrëveshjes vullnetare, njofton kërkuesin për pamundësinë e lidhjes së marrëveshjes.

8. Marrëveshjet vullnetare lidhen për një periudhë të caktuar, bazuar në jetëgjatësinë e projektit të propozuar.

9. Formati i marrëveshjes vullnetare miratohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për mjedisin.

10. Ministria përgjegjëse për mjedisin krijon regjistrin me të dhënat e marrëveshjeve vullnetare, ku vendoset numri i regjistrimit për secilën kërkesë dhe për secilën marrëveshje vullnetare të lidhur, dhe e publikon në faqen e saj elektronike.

11. Ministria përgjegjëse për mjedisin mund ta prishë marrëveshjen vullnetare kur nuk përmbushen kriteret dhe kushtet, në bazë të të cilave ajo është lidhur, bazuar në rezultatet e monitorimit të parametrit/ave të përbërësit/ve të mjedisit, objekt i marrëveshjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij 3 (tre) muaj pas botimit.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 598, datë 1.7.2015

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDISIN NDËRKUFITAR[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 23, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. NJOFTIMI FILLESTAR I ZHVILLUESIT TË PROJEKTIT

1. Zhvilluesi, që synon të zbatojë një projekt, i cili është subjekt i procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, aplikon pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin, në vijim ministria, për vlerësimin e ndikimit në mjedis paraprak apo të thelluar, sipas legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

2. Ministria, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune pas marrjes së aplikimit, vlerëson nëse projekti i propozuar është i listuar në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe nëse mund të ketë efekte të rëndësishme në mjedisin e një apo më shumë shteteve fqinje, bazuar në identifikimin e ndikimeve ndërkufitare sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Kur plotësohen kushtet e pikës 2, të këtij vendimi, ministria i kërkon me shkrim zhvilluesit të ndjekë procedurat e këtij vendimi, të plotësojë formatin e njoftimit të shtetit fqinj dhe dokumentacionin e kërkuar në të, bazuar në shtojcën 4, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Në rastin kur projekti i propozuar duhet t'i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) në kontekst ndërkufitar, zbatohen vetëm procedurat dhe afatet e përcaktuara në këtë vendim për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

II. NJOFTIMI NGA MINISTRIA I PALËS SË PREKUR

1. Zhvilluesi i projektit plotëson formatin e njoftimit dhe dokumentacionin e kërkuar në të, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, me shpenzimet e tij.

2. Ministria, brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga marrja e formatit të njoftimit dhe dokumentacionit shoqërues, përcjell praktikën në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë për të njoftuar palën e prekur për projektin e propozuar që do t'i nënshtrohet procesit të VNM-së në kontekst ndërkufitar, dhe e fton të marrë pjesë në procedurën përkatëse. Njoftimi shoqërohet me formatin e njoftimit të shtetit fqinj dhe dokumentacionin e kërkuar në të në gjuhën angleze.

3. Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë ia përcjell palës së prekur praktikën brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga data e marrjes së saj.

4. Ministria, brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga data e marrjes së formatit të njoftimit dhe dokumentacionit shoqërues, ua përcjell praktikën për mendim/konsultim në lidhje me çështjet që kërkojnë të merren parasysh në raportin e VNM-së institucioneve të mëposhtme, duke u theksuar edhe afatin prej 20 (njëzet) ditësh pune për dërgimin e mendimit të tyre:

a) Ministrive të linjës, të cilat kanë përgjegjësi në planifikimin e territorit, mbrojtjen e shëndetit publik, menaxhimin e burimeve ujore, tokës bujqësore, zhvillimit të ekonomisë, zhvillimit të

[1] Ky vendim synon të bëjë përafrimin e plotë të Direktivës 2011/92/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 dhjetor 2011, "Për vlerësimin e ndikimeve që shkaktohen në mjedis nga projekte publike dhe private" (celex-32011L0092, OJ. L 26, 28.1.2012), të ndryshuar me Direktivën 2014/52/EU, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 16 prill 2014 (celex-32014L0052, OJ. L 124, 25.4.2014).

industrisë dhe energjisë, si dhe zhvillimin e infrastrukturës publike, në varësi të projektit;

b) Institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për emergjencat natyrore dhe civile;

c) Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe agjencisë rajonale të mjedisit të qarkut ku propozohet të zbatohet projekti, të cilat kërkojnë mendimin nga njësia/njësitë e qeverisjes vendore.

5. Nëse pala e prekur shpreh se nuk ka interes të marrë pjesë në procedurën e VNM-së në kontekst ndërkufitar apo nuk shprehet brenda afatit të përcaktuar në njoftimin e ministrisë dhe në formatin e njoftimit, i cili nuk mund të jetë më shumë se 6 (gjashtë) javë, procedura e VNM-së vijon të kryhet pa përfshirjen e palës së prekur, në përputhje me procedurat e legjislacionit në fuqi për VNM-në.

6. Në rastin kur pala e prekur shfaq interes për të marrë pjesë në procedurën e VNM-së në kontekst ndërkufitar, ministria e fton atë të marrë pjesë në procedurat e VNM-së, si më poshtë:

a) Konsultimi për çështjet që duhet të trajtojë raporti i VNM-së;

b) Procesi i informimit dhe pjesëmarrjes së publikut, sipas procedurave të legjislacionit në fuqi për rregullat, kërkesat dhe procedurat për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, si dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi të palës së prekur;

c) Vendimmarrja lidhur me deklaratën mjedisore.

7. Pala e prekur, në rastin kur shfaq interes për të marrë pjesë në procedurën e VNM-së në kontekst ndërkufitar, duhet t'i dërgojë ministrisë emrin dhe të dhënat e personit/personave të kontaktit që do të koordinojë konsultimet dhe takimet.

8. Ministria, në rast se gjykohet e nevojshme gjatë procedurës së VNM-së, mund t'i kërkojë palës së prekur informacion lidhur me gjendjen e mjedisit që ka gjasa të ndikohet në mënyrë të konsiderueshme. Pala e prekur përgjigjet në gjuhën angleze dhe përgjigjja përfshin informacion në lidhje me madhësinë e zonës, gjendjen e mjedisit, aktivitetet e pajisura me leje mjedisi në atë zonë, zonat e mbrojtura dhe çdo informacion tjetër që pala e prekur gjykon të nevojshëm. Përgjigjja dërgohet brenda një periudhe kohore të arsyeshme, por jo më shumë se dy muaj. Përkthimi i materialeve nga gjuha e palës së prekur në gjuhën angleze do të përballohet me shpenzimet e zhvilluesit të projektit.

9. Ministria i kërkon palës së prekur që, brenda dy muajve nga marrja e njoftimit, në rast se ka shfaqur interes për të të marrë pjesë në procedurën e VNM-së në kontekst ndërkufitar, t'i dërgojë një përmbledhje në gjuhën angleze të komenteve dhe sugjerimeve të publikut të dhe autoritetit përgjegjës për mjedisin të palës së prekur, në lidhje me çështjet që kërkojnë të merren parasysh në raportin e VNM-së. Përkthimi i materialeve nga gjuha e palës së prekur në gjuhën angleze do të përballohet me shpenzimet e zhvilluesit të projektit.

10. Ministria njofton, me shkrim, zhvilluesin për çështjet që duhet të trajtojë në raportin e VNM-së, ku përfshin edhe informacionin e paraqitur nga pala e prekur sipas përcaktimeve të pikës 9, të këtij kreu, si dhe informacionin e paraqitur nga institucionet e konsultuara, sipas përcaktimeve të pikës 4, të këtij kreu.

11. Raporti i VNM-së në kontekst ndërkufitar, përveç kërkesave të metodologjisë kombëtare, ku përcaktohen metodikat dhe kërkesat për hartimin e raporteve të VNM-së, informacionit të paraqitur nga pala e prekur, sipas përcaktimeve të pikës 9, të këtij kreu, dhe informacionit të paraqitur nga institucionet e konsultuara, sipas përcaktimeve të pikës 4, të këtij kreu, duhet të përfshijë edhe informacionin e kërkuar në shtojcën 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

III. PROCEDURA E DËRGIMIT TË RAPORTIT TË VNM-së

1. Ministria, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e dorëzimit të raportit të VNM-së nga ana e zhvilluesit, ia dërgon atë palës së prekur, së bashku me përmbledhjen joteknike të këtij raporti. Të dyja dokumentet duhet të jenë të përkthyera në gjuhën angleze me shpenzimet e zhvilluesit të projektit. Në shkresën përcjellëse duhet të shënohet dhe koha në të cilën pritet përgjigjja nga pala e prekur, e cila nuk mund të jetë më shumë se dy muaj.

2. Ministria, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e dorëzimit të raportit të VNM-së nga

ana e zhvilluesit, ua dërgon një kopje të tij për mendim/konsultim, së bashku me përmbledhjen joteknike të këtij raporti, institucioneve të mëposhtme, duke u theksuar afatin prej 20 (njëzet) ditësh pune për dërgimin e mendimit të tyre:

a) Ministrive të linjës, të cilat kanë përgjegjësi në planifikimin e territorit, mbrojtjen e shëndetit publik, menaxhimin e burimeve ujore, tokës bujqësore, zhvillimit të ekonomisë, zhvillimit të industrisë dhe energjisë, si dhe zhvillimin e infrastrukturës publike, në varësi të projektit;

b) Institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/ licencimin e tij apo përgjegjëse për emergjencat natyrore dhe civile;

c) Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe agjencisë rajonale të mjedisit (ARM) të qarkut ku propozohet të zbatohet projekti, të cilat kërkojnë mendimin nga njësia/njësitë e qeverisjes vendore.

3. Pala e prekur e shqyrton dhe e konsulton raportin e VNM-së bazuar në procedurat e përcaktuara në legjislacionin e saj kombëtar dhe i dërgon ministrisë komentet ose vërejtjet e përftuara nga publiku apo autoritetet.

4. Ministria, në bashkëpunim me zhvilluesin, organizon dëgjesat me publikun sipas procedurave të legjislacionit në fuqi për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, ku fton edhe palën e prekur të marrë pjesë gjatë këtyre dëgjesave. Shpenzimet në këtë rast mbulohen nga zhvilluesi.

5. Ministria dhe zhvilluesi duhet të marrin pjesë në dëgjesat e publikut të organizuara nga pala e prekur lidhur me konsultimin dhe shqyrtimin e raportit të VNM-së. Konsultimet në këtë fazë nuk mund të zgjasin më tepër se dy muaj nga data e marrjes së raportit të VNM-së nga pala e prekur. Shpenzimet mbulohen nga zhvilluesi.

6. Bazuar në rezultatet e dëgjesave, të përcaktuara në pikat 3 dhe 4, të këtij kreu, zhvilluesi përfshin në raportin përfundimtar të VNM-së komentet dhe sugjerimet lidhur me dhënien e alternativave për zgjidhjen e çështjeve/problemeve të ngritura gjatë debateve, si dhe komentet/sugjerimet nga institucionet e konsultura sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij kreu. Raporti përfundimtar i VNM-së i dërgohet Ministrisë.

7. Ministria, mbas paraqitjes së raportit përfundimtar të VNM-së nga zhvilluesi sipas pikës 5 të këtij kreu, shqyrton këtë raport brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune.

8. Ministria, gjatë fazës së shqyrtimit ndërmerr konsultime me autoritetin përgjegjës së palës së prekur lidhur me masat për minimizimin apo eliminimin e ndikimit të mundshëm ndërkufitar nga projekti i propozuar. Konsultimet në këtë fazë nuk mund të zgjasin më tepër se 30 (tridhjetë) ditë pune.

IV. MARRJA E VENDIMIT PËRFUNDIMTAR

1. Ministria, pas shqyrtimit, harton deklaratën mjedisore, e cila firmoset nga ministri.

2. Deklarata mjedisore për projektin e propozuar bazohet në dokumentacionin dhe raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedisin ndërkufitar, në rezultatet e konsultimeve të realizuara me palën e prekur, në komentet / sugjerimet nga institucionet e konsultura, si dhe në komentet e publikut.

3. Ministria i dërgon një kopje të deklaratës mjedisore për zhvillimin e veprimtarisë në zonë kufitare palës së prekur, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e lëshimit të saj.

4. Nëse Ministria, pa filluar funksionimin projekti, merr informacion të ri për ndikime të tjera mjedisore negative ndërkufitare që mund të shfaqen, por që nuk ishin të ditura në momentin kur lëshoi deklaratën mjedisore dhe që mund të kenë ndikuar në përmbajtjen e saj, informon zyrtarisht palën e prekur.

5. Nëse pala e prekur kërkon të konsultohet për rishikimin e deklaratës mjedisore, ministria hyn në konsultime për nevojën e rishikimit ose jo të saj.

V. ANALIZA E VEPRIMTARISË GJATË USHTRIMIT TË SAJ

1. Nëse autoriteti kompetent i palës së prekur kërkon të kryhet një analizë për ndikimet mjedisore ndërkufitare pasi projekti ka filluar të funksionojë, ministria zhvillon konsultime me palën e prekur për kryerjen ose jo të kësaj analize, si dhe për çështjet që do të trajtohen në të.

2. Nëse do të zhvillohet analiza, ajo do të fokusohet në rivlerësimin e çdo ndikimi negativ përtej kufijve të parashikuar gjatë vendimmarrjes, duke përfshirë edhe çështjet e mëposhtme:

a) monitorimin e zbatimit të kushteve të deklaratës mjedisore dhe/ose lejes mjedisore si dhe efektshmërinë e masave të marra për zbutjen e ndikimeve mjedisore;

b) rivlerësimin e ndonjë ndikimi mjedisor negativ, me qëllim përmirësimin e masave për kontrollin e tij;

c) verifikimin e parashikimeve të ndikimeve mjedisore, me qëllim që të përdoret përvoja për veprimtari të njëjta në të ardhmen.

3. Në rastet kur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe palës së prekur apo palëve të prekura është lidhur marrëveshje dy-a më-shumëpalëshe lidhur me procedurat e VNM-së ndërkufitare, bazuar në Konventën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, atëherë do të zbatohen procedurat dhe rregullat e përcaktuara në to.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim që u jepet, përkatësisht, në:

a) ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar;

b) ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar;

c) Konventën për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekstin ndërkufitar, Espoo, Finlandë, 25 shkurt 1991.

1. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 shtator 2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1
LISTA E AKTIVITETEVE QË I NËNSHTROHEN PROCEDURËS SË VNM-së NË KONTEKST NDËRKUFITAR

1. Rafineri të naftës bruto (duke përjashtuar sipërmarrje për prodhimin e lubrifikanteve nga nafta bruto) dhe instalime për gazifikimin dhe lëngëzimin e 500 tonëve metrikë ose më tepër qymyr apo rërë bituminoze në ditë.

2. a) Termocentrale të prodhimit të energjisë dhe impiante të tjera të djegies me prodhim nxehtësie prej 300 megavat ose më shumë; b) Stacione bërthamore dhe reaktorë të tjerë bërthamorë duke përfshirë çmontimin dhe heqjen nga funksionimi të këtyre stacioneve dhe reaktorëve bërthamorë 1 (duke përjashtuar impiantet kërkimore për prodhimin dhe konvertimin e materialeve të ndashme ose ushqyese, fuqia maksimale e të cilëve nuk e kalon 1 kW ngarkesë termike të vazhdueshme).

3. a) Instalime për ripërpunimin e karburantit bërthamor të rrezatuar.

b) Instalime të projektuara:

- Për prodhimin dhe pasurimin e karburantit bërthamor;
- Për përpunimin e karburantit bërthamor të rrezatuar ose mbetjeve me nivel të lartë radioaktiviteti;
- Për depozitimin përfundimtar të karburantit bërthamor të rrezatuar;
- Vetëm për depozitimin përfundimtar të mbetjeve radioaktive;
- Vetëm për ruajtjen (e planifikuar për më shumë se 10 vjet) të karburantit bërthamor të rrezatuar ose mbetjes radioaktive në një vend të ndryshëm nga vendi i prodhimit.

4. Instalime të mëdha për shkrirjen fillestare të gizës dhe çelikut dhe për prodhimin e metaleve pa përmbajtje hekuri.

5. Instalime për nxjerrjen e asbestit dhe për përpunimin dhe transformimin e asbestit dhe produkteve që përmbajnë asbest: për produktet e asbest-çimentos, me një prodhim vjetor prej më shumë se 20 000 tonë metrikë produkt përfundimtar; për materiale fërkimi, me një prodhim vjetor prej më shumë se 50 tonë metrikë produkt përfundimtar dhe për përdorimin e llojeve të tjera të asbestit për më shumë se 200 tonë metrikë në vit.

6. Instalime kimike të integruara.

7. a) Ndërtimi i autostradave, rrugëve të shpejtësisë 2/ dhe linjave të distancave të gjata të trafikut hekurudhor dhe të aeroporteve 3/ me pistë bazë (ngritje-ulje) prej 2100 metrash ose më tepër.

b) Ndërtimi i një rruge të re me katër korsi ose më shumë, ose riorganizimi dhe/ose zgjerimi i një rruge ekzistuese me dy ose më pak korsi për të siguruar katër ose më shumë korsi ku kjo rrugë e re ose riorganizimi dhe/ose zgjerimi i seksionit të rrugës do të jetë 10 km ose më shumë në gjatësi të vazhduar.

8. Tubacionet me diametër të madh për transportimin e naftës, gazit ose kimikateve.

9. Portet tregtare dhe gjithashtu rrugët ujore të brendshme dhe portet për trafikun ujor të brendshëm që lejojnë kalimin e anijeve me tonazh mbi 1350 tonë metrikë.

10. a) Instalime të depozitimit të mbeturinave për djegie, trajtim kimik ose groposje për mbetje toksike dhe të rrezikshme.

b) Instalime të depozitimit të mbeturinave për djegie ose trajtim kimik të mbetjeve të parrezikshme me kapacitet mbi 100 tonë metrikë në ditë.

11. Diga dhe rezervuarë të mëdhenj.

12. Aktivitetet e nxjerrjes së ujërave nëntokësore ose skemat artificiale të ringarkimit të ujërave nëntokësore, ku vëllimi vjetor i sasive të ujërave të nxjerra ose të ringarkuara është 10 milionë m^3 ose më shumë.

13. Prodhimi i letrës, brumit të letrës dhe kartonit me kapacitet 200 tonë metrikë në ditë ose më shumë, i tharë me ajër.

14. Miniera dhe kariera (gurore) të mëdha, nxjerrja dhe përpunimi në vend i mineraleve metalike ose qymyrit.

15. Prodhimi i hidrokarbureve në det. Nxjerrja e naftës dhe e gazit natyror për qëllime tregtare ku sasia e nxjerrë kalon 500 tonë metrikë në ditë në rastin e naftës dhe 500 000 m^3 në ditë në rastin e gazit.

16. Impiante të mëdha për ruajtjen e naftës, produkteve petrokimike dhe kimike.

17. Shpyllëzimi i zonave të mëdha.

18. a) Punime për transferimin e burimeve ujore ndërmjet baseneve të lumenjve, ku transferimi synon parandalimin e pakësimit të ujërave, dhe ku sasia e ujërave të transferuara është më e madhe se 100 milionë m^3 në vit;

b) Në të gjitha rastet e tjera, punime për transferimin e burimeve ujore nga basenet e lumenjve ku rrjedha shumëvjeçare e basenit është më e madhe se 2000 milionë m^3 në vit dhe ku sasia e ujit të transferuar është më e madhe se 5 për qind e kësaj rrjedhjeje. Në të dyja rastet përjashtohet transferimi i ujit të pijshëm me tubacione.

19. Impiante për trajtimin e ujërave të ndotura me kapacitet që e kalon ekuivalentin e një popullsie 150 000 banorë.

20. Instalimet për rritjen intensive të shpendëve dhe derrave që kanë më shumë se:

a) 85 000 vende për zogj;

b) 60 000 vende për pula;

c) 3000 vende për derra (mbi 30 kg);

ç) 900 vende për dosa

21. Ndërtimi i linjave ajrore të tensionit të lartë me një tension 220 kW ose më shumë dhe një gjatësi prej më shumë se 15 km.

22. Instalime të mëdha për shfrytëzimin e kombinuar të fuqisë së erës për prodhim energjie (fermat e erës).

* Shënim në lidhje me shtojcën:

Stacionet e fuqisë bërthamore dhe reaktorët e tjerë bërthamorë pushojnë së qeni instalime të tilla kur i gjithë karburanti bërthamor dhe elementet e tjera të ndotura radioaktive janë zhvendosur përfundimisht nga vendi i instalimit.

- "Autostradë" është një rrugë e projektuar dhe e ndërtuar për trafik automobilistik, që nuk u shërben zonave përreth dhe, e cila:

a) është e pajisur, me përjashtim të pikave të veçanta ose përkohësisht, me karrexhata të ndara për të dy drejtimet e trafikut, të ndara nga njëra-tjetra nga një vijë ndarëse që nuk shkelet nga trafiku ose, në raste të rralla, me mjete të tjera;

b) nuk ndërpritet në të njëjtin nivel nga ndonjë rrugë, shinë hekurudhe ose tramvaji apo rrugë këmbësorësh;

c) është e sinjalizuar në mënyrë të veçantë si autostradë.

- "Rrugë shpejtësie" është një rrugë e rezervuar për trafik makinash ku hyrja mund të bëhet vetëm nga kryqëzimet në disnivel ose kryqëzimet e kontrolluara dhe në të cilën veçanërisht ndalimi dhe parkimi janë të ndaluara përgjatë karrexhatave të lëvizjes.

- "Aeroport" do të thotë një aeroport që është në pajtim me përkufizimin e Konventës së Çikagos, të vitit 1944, për krijimin e Organizatës së Aviacionit Civil (aneksi 14).

SHTOJCA 2
IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË RËNDËSISHME MJEDISORE NDËRKUFITARE

Kritere të përgjithshme për të ndihmuar në vlerësimin e veprimtarisë:

1. Madhësia e projektit: Lloji i veprimtarisë, sipërfaqja e tokës që do përdoret dhe operacionet

që do të kryhen në të, kapaciteti prodhues dhe lëndët e para, përdorimi i burimeve natyrore dhe sasia e tyre, lloji dhe sasia e shkarkimeve në mjedis, kërkesat dhe konsumi i energjisë, objektet dhe infrastruktura që do të ndërtohet, lloji i mbetjeve dhe sasia e gjenerimit të tyre.

2. Vendosja: Veprimtaria e propozuar do të zhvillohet në zonë ndërkufitare dhe pranë vijës kufitare, në një zonë të mbrojtur, me rëndësi ndërkombëtare, pranë burimeve ujore, në një zonë me ndjeshmëri ekologjike (habitat i llojeve), afër qendrave të banuara dhe në afërsi të objekteve kulturore, në një terren të pjerrët me ekspozim nga territori i shtetit fqinj.

3. Pasojat: Veprimtaria e propozuar do të ketë ndikime të rëndësishme negative mjedisore që dalin përtej kufijve territorialë të Republikës së Shqipërisë dhe në shkallë të ndryshme ndikojnë negativisht në vlerat natyrore të shtetit/eve fqinj, si dhe në shëndetin e popullsisë. Në disa raste, veprimtaria e propozuar mund të shkaktojë efekte të rëndësishme ndërkufitare shumë të zhvendosura nga vendi i zhvillimit të saj dhe që mund të kalojnë përtej kufijve të një shteti fqinj.

Çështje që duhet të merren në konsideratë lidhur me vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve mjedisore:

1. Shkarkimet në ajër të gazeve ndotëse që mund të ndryshojnë cilësinë e ajrit në zonë;

2. Shkarkimet e lëndëve ndotëse në ujërat sipërfaqësor I', përrenj, lumenj, liqene dhe det;

3. Prerjet masive të drurëve apo shpyllëzimet në sipërfaqe të konsiderueshme;

4. Afërsia e vendndodhjes së projektit me zona të mbrojtura;

5. Mundësia që aktiviteti i propozuar të shkaktojë aksidente që mund të kenë ndikime ndërkufitare.

6. A lidhet aktiviteti i propozuar me ndonjë marrëveshje ndërkombëtare për çështjet mjedisore.

SHTOJCA 3
INFORMACIONI I KËRKUAR NË RAPORTIN E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS NDËRKUFITAR

Informacioni i përfshirë në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis ndërkufitar duhet të përmbajë si minimum:

a) Një përshkrim të aktivitetit të propozuar dhe qëllimin e tij;

b) Kur është e përshtatshme, një përshkrim të alternativave të arsyeshme (për shembull, vendndodhjeje ose teknologjike) të aktivitetit të propozuar si dhe të alternativës së mosveprimit.

c) Një përshkrim të mjedisit të mundshëm për t'u prekur në mënyrë serioze nga veprimtaria e propozuar e alternativat e saj;

ç) Një përshkrim të ndikimit potencial të mjedisit nga veprimtaria e propozuar e alternativat e saj, si dhe një vlerësim i rëndësisë së tij;

d) Një përshkrim të masave lehtësuese për të mbajtur në minimum ndikimin negativ në mjedis;

dh) Një tregues të qartë të metodave parashikuese, supozimeve të theksuara, si dhe të dhënave përkatëse të rëndësishme për mjedisin që janë përdorur;

e) Identifikim të mungesave në njohuri dhe pasiguri të ndeshura në përpilimin e informacionit të kërkuar;

ë) Kur duhet, një përshkrim të programeve të monitorimit e drejtimit e të planeve për analizë pas projektit dhe

f) Një përmbledhje joteknike, që përfshin prezantimin vizual, si harta, grafikë etj.

SHTOJCA 4
FORMATI I NJOFTIMIT TË SHTETIT FQINJ

Njoftimi që do t'i dërgohet autoritetit kompetent të shtetit fqinj përmban:

1. Informacion për projektin apo veprimtarinë:

a) Lloji i aktivitetit të propozuar;

b) A gjendet aktiviteti në listën e aktiviteteve të përcaktuara në aneksin I, të konventës së VNM-së në kontekst ndërkufitar;

c) Qëllimi i aktivitetit të propozuar;

ç) Madhësia e aktivitetit të propozuar;

d) Përshkrimi i shkurtër i aktivitetit të propozuar (teknologjia që do përdoret).

2. Kufijtë hapësinorë dhe kohorë të aktivitetit të propozuar:

a) Vendi ku do të ushtrohet projekti (hartë, skica, planimetri etj.);

b) Përshkrimi i shkurtër i mjedisit (mjedisi gjeografik e fizik dhe qendrat e banuara pranë tij);

c) Arsyet e përzgjedhjes së vendndodhjes;

ç) Afatet kohore të aktivitetit të propozuar (koha e ndërtimit dhe e funksionimit);

d) Harta dhe foto me informacion për aktivitetin e propozuar.

3. Të dhëna për ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat zbutëse të parashikuara:

a) Qëllimi i vlerësimit (ndikimet kumulative, vlerësimi i alternativave etj.);

b) Ndikimet e mundshme mjedisore të aktivitetit të propozuar (natyra e ndikimit, madhësia etj.);

c) Lëndët e para (materialet si lëndë e parë, burimi i energjisë etj.);

ç) Shkarkime në mjedis (lloji dhe përmasa e shkarkimeve në ajër /shkarkimet e lëngëta dhe mbetjet e ngurta);

d) Ndikimet e mundshme mjedisore ndërkufitare (lloji, përmasa);

dh) Masat zbutëse të propozuara (nëse jepen masat për parandalimin, eliminimin, minimizimin dhe kompensimin e pasojave në mjedis).

4. Propozuesi i aktivitetit:

Emri, adresa, telefoni, faksi dhe adresën e komunikimit elektronik.

5.Pika e kontaktit:

a) Pika e kontaktit në Ministrinë e Mjedisit;

b) Autoriteti përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis;

c) Adresa, telefoni dhe numri i faksit, si dhe adresa e komunikimit elektronik;

ç) Autoriteti i vendimmarrjes përfundimtare.

6. Afati brenda të cilit pritet përgjigje:

Afati kohor/data e fundit e dërgimit të përgjigjes në ministri.

VENDIM
Nr. 599, datë 1.7.2015

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË VENDIMIN NR. 54, DATË 21.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I OBJEKTIT "STUDIM, PROJEKTIM, LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME SUPERSTRADËN FIER-VLORË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.199, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 54, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikat 3 dhe 4, vlera "582 942 635.82 (pesëqind e tetëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e dy) lekë" bëhet "582 407 368.82 (pesëqind e tetëdhjetë e dy milionë e katërqind e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë tetëdhjetë e dy) lekë".

2. Tabela bashkëlidhur vendimit zëvendësohet me tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Nr	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Pronari	Sipërfaqe trualli	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i truallit, lekë	Çmimi i ndërtimit, lekë	Vlera e truallit, lekë	Vlera e ndërtimit, lekë	Vlera truall dhe ndërtesë	Shënime
1	8605	33/426	Skender Alibehaj	64.1	0	8300	52,024.00	532,030.00	-	532,030.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	8605	33/377	Metlli Sinanaj	68.2	98.6	8300	52,024.00	566,060.00	4,817,237.40	5,383,297.40	Konfirmuar nga ZVRPP-ja. Mbajtur vlera e truallit për sipërfaqen e ndërtesës jashtë vijës së shpronësimit.
3	8605	33/373	Metlli Sinanaj	178	76	8300	52,024.00	1,477,400.00	3,377,804.00	4,855,204.00	Konfirmuar nga ZVRPP. Mbajtur vlera e truallit për sipërfaqen e ndërtesës jashtë vijës së shpronësimit.
4	8605	33/402	Sami Kembaci	185	42.2	8300	52,024.00	1,535,500.00	2,195,412.80	3,730,912.80	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	8605	33/375	B.P. Mersini	146	82.5	8300	52,024.00	1,211,800.00	4,291,980.00	5,503,780.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	8605	33/19	B.P. Mucaj	0	60	8300	52,024.00	-	3,121,440.00	3,121,440.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	8605	33/345-Nd	Flamur Hoxha	0	63.7	8300	52,024.00	-	3,313,928.80	3,313,928.80	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	8605	33/45-ND	Matilda Bufazi	0	71	8300	52,024.00	-	3,693,704.00	3,693,704.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	8605	33/371	Matilda Bufazi	23.2	0	8300		192,560.00	-	192,560.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	8605	33/399	Danish Hoxhaj	272	99	8300	52,024.00	2,257,600.00	5,150,376.00	7,407,976.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja sipërfaqe banimi
11	8605	33/399	Danish Hoxhaj	0	72		52,024.00		911,875.00	911,875.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Sipërfaqe zdrukthëtarie vlerësim me situacion
12	8605	33/410 (33/310)	B.P. Bataj	239	111	8300	52,024.00	1,983,700.00	5,774,664.00	7,758,364.00	Konfirmuar nga ZVRPP
13	8605	33/381	Edmond Bregu	84.5	109	8300	52,024.00	701,350.00	5,670,616.00	6,371,966.00	Hipotekohet në emër të Bankës PRO Credit Konfirmuar nga ZVRPP
14	8605	33/382	Dashamir Rrapushi	367.1	131.4	8300	52,024.00	3,046,930.00	6,835,953.60	9,882,883.60	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
15	8605	33/358	Zace Sejdi	184.1	115.9	8300	52,024.00	1,528,030.00	6,029,581.60	7,557,611.60	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
16	8605	33/364	Lutfi Shuaipi	214.2	85.8	8300	52,024.00	1,777,860.00	4,463,659.20	6,241,519.20	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
17	8605	33/365	Thabit Shuaipi	161	139	8300	52,024.00	1,336,300.00	7,231,336.00	8,567,636.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
18	8605	33/372	Xhelal Mezani	234	66	8300	52,024.00	1,942,200.00	3,433,584.00	5,375,784.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
19	8605	33/379	Enver Mezani	305.5	374	8300	52,024.00	2,535,650.00	17,697,376.00	20,233,026.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja 2 kate, 162 m² kati i parë, 212 kati i dytë. Mbajtur vlera e truallit për katin e dytë.
20	8605	33/390	Pellumb Lule	189.1	65.2	8300	52,024.00	1,569,530.00	3,391,964.80	4,961,494.80	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
21	8605	33/400	Et'hem Driza	134.6	369.7	8300	52,024.00	1,117,180.00	17,537,582.80	18,654,762.80	Konfirmuar nga ZVRPP-ja kati I 165.4 m², kati II 204.3 m². Mbajtur vlera e truallit për katin II
22	8605	33/418	Metlli Shehu	248.2	80.8	8300	52,024.00	2,060,060.00	4,203,539.20	6,263,599.20	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
23	8605	2/201	Alban Gjolekaj	296.8	223	8300	52,024.00	2,463,440.00	10,572,152.00	13,035,592.00	Në favor të Intesa San Paolo. Konfirmuar nga ZVRPP 2 kate, K I 99 m², K II 124 m². Mbajtur vlera e truallit për katin e dytë.
24	8605	2/57+1-3	Bp. Diku		50		52,024.00		2,601,200.00	2,601,200.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
25	8605	2/57+1-1	Bp. Hysaj		50		52,024.00		2,601,200.00	2,601,200.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
26	8605	2/57+1-2	Bp. Hameti		65		52,024.00		3,381,560.00	3,381,560.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
27	8605	33/368	Miroshe Metushaj	27.5	0	8300	52,024.00	228,250.00	-	228,250.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
28	8605	33/331	B.P. Agalliu	600	0	8300	52,024.00	4,980,000.00	-	4,980,000.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
29	8605	33/335/1	Agron Dine, Ardian Dine, Engjell Dine, Leonel Kokoshi, Lindita Kili, Natasha Toto, Osvalda Balli, Selvi Sina,	275.53	0	8300	52,024.00	2,286,899.00	-	2,286,899.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja

			Sokol Kokoshi, Themida Kondi, Yllka Lamaj								
		33/335/2	Agron Dine, Ardian Dine, Engjell Dine, Leonel Kokoshi, Lindita Kili, Natasha Toto, Osvalda Balli, Selvi Sina, Sokol Kokoshi, Themida Kondi, Yllka Lamaj	890.47	0	8300	52,024.00	7,390,901.00	-	7,390,901.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
30	8605	33/340	B.P. Alibehaj	23.1	0	8300	52,024.00	191,730.00	-	191,730.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
31	8605	33/437	B.P. Agalliu	82.2	0	8300	52,024.00	682,260.00	-	682,260.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
32	8605	33/408	Hiqmet Shoraj	96.3	0	8300	52,024.00	799,290.00	-	799,290.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
33	8605	22/273	Mustafa Myzeqari	20.7	0	8300	52,024.00	171,810.00	-	171,810.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
34	8605	33/432	B.P. Agalliu	446.6	0	8300	52,024.00	3,706,780.00	-	3,706,780.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
35	8605	11/73/2	Moisi Lazaj,Fatmir Lazaj	194	0	8300	52,024.00	1,610,200.00	-	1,610,200.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
36	8605	11/75	B.P. Lulja	1848.5	0	8300	52,024.00	15,342,550.00	-	15,342,550.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
37	8605	11/84	Riza Lule	1511.9	0	8300	52,024.00	12,548,770.00	-	12,548,770.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
38	8605	11/92	B.P. Agalliu	2045.4	0	8300	52,024.00	16,976,820.00	-	16,976,820.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
39	8605	11/174	Shoqeria "Selmani" SH.P.K	506.6	0	8300	52,024.00	4,204,780.00	-	4,204,780.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
40	8605	11/141	B.P. Agalliu	8385.9	0	8300	52,024.00	69,602,970.00	-	69,602,970.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
41	8605	2/35	B.P. Agalliu	3687	0	8300	52,024.00	30,602,100.00	-	30,602,100.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
42	8605	2/65	B.P. Agalliu	2710.6	0	8300	52,024.00	22,497,980.00	-	22,497,980.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
43	8605	11/118	Mirjam Ibrahimi	3594	0	8300	52,024.00	29,830,200.00	-	29,830,200.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
44	8605	11/139	B.P. Agalliu	1040	0	8300	52,024.00	8,632,000.00	-	8,632,000.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
45	8605	2/208/1	B.P. Agalliu	5400.1	0	8300	52,024.00	44,820,830.00	-	44,820,830.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
46	8605	2/209	B.P. Agalliu	731	0	8300	52,024.00	6,067,300.00	-	6,067,300.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
47	8605	11/82	B.P. Bino	4877.2	0	8300	52,024.00	6,746,793.33	-	6,746,793.33	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
					0	8300	52,024.00	6,746,793.33	-	6,746,793.33	
					0	8300	52,024.00	6,746,793.33	-	6,746,793.33	
					0	8300	52,024.00	6,746,793.33	-	6,746,793.33	
					0	8300	52,024.00	1,349,358.67	-	1,349,358.67	
					0	8300	52,024.00	1,349,358.67	-	1,349,358.67	
					0	8300	52,024.00	1,349,358.67	-	1,349,358.67	
					0	8300	52,024.00	1,349,358.67	-	1,349,358.67	
					0	8300	52,024.00	1,349,358.67	-	1,349,358.67	
					0	8300	52,024.00	1,686,698.33	-	1,686,698.33	
					0	8300	52,024.00	1,686,698.33	-	1,686,698.33	
					0	8300	52,024.00	1,686,698.33	-	1,686,698.33	
					0	8300	52,024.00	562,232.78	-	562,232.78	
					0	8300	52,024.00	562,232.78	-	562,232.78	
					0	8300	52,024.00	562,232.78	-	562,232.78	
48	8605	33/417	Maksim Hitaj	382	81	8300	52,024.00	3170600	4213944	7,384,544.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
49	8605	33/417	Maksim Hitaj		41				693825	693,825.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja, objekt soc-ek, vlera sipas situacionit
50	8605	2/35-nd	Eduart Feka		116	8300	52,024.00	962,800.00	6,034,784.00	5,071,984.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
51	8605	33/344-Nd	Kudret Zhorri	0	63.7	8300	52,024.00	-	3,313,928.80	3,313,928.80	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
52	8605	33/343	Bp. Mehmeti	20.32	82.68	8300	52,024.00	168,656.00	4,301,344.32	4,470,000.32	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
53	8605	33/359	Gjyzela Alibehaj	54	0	8300	52,024.00	448,200.00	0	448,200.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
54	8605	33/360	Gjyzela Alibehaj	54	0	8300	52,024.00	448,200.00	0	448,200.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
55	8605	33/404	Agim Shehu	225.3	64.7	8300	52,024.00	1869990	3365952.8	5,235,942.80	Konfirmuar nga ZVRPP-ja

56	8605	33/431-ND 3	Izet Shuaipi	0	36.57	8300	52,030.00	303531	1902737.1	1,599,206.10	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
57	8605	2/208-ND	Haki Haxhiraj	0	52.17	8300	52,030.00	433011	2714405.1	2,281,394.10	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
58	8605	33/431-ND1	Petrit Ismail Shuaipi	0	63.94	8300	52,030.00	530702	3326798.2	2,796,096.20	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
59	8605	2/65-ND1	Bashkim Kasa	0	83.12	8300	52,030.00	689896	4324733.6	3,634,837.60	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
60	8605	33/431-ND4	Adile Shuaipi	0	65.03	8300	52,030.00	539749	3383510.9	2,843,761.90	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
61	8605	33/431-ND2	Xhafer Ismail Shuaipi	0	56.41	8300	52,030.00	468203	2935012.3	2,466,809.30	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
62	8605	33/391-ND2	Arben Lule	0	70.15	8300	52,030.00	582245	3649904.5	3,067,659.50	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
63	8605	33/391-ND1	Gezim Haxhi Lule	0	63.13	8300	52,030.00	523979	3284653.9	2,760,674.90	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
64	8605	2/65-ND3	Bilbil Llojaj	0	62.24	8300	52,030.00	516592	3238347.2	2,721,755.20	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
65	8605	2/65-ND2	Armando Salataj	0	50.84	8300	52,030.00	421972	2645205.2	2,223,233.20	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
66	8605	33/54-ND	Zenel Qamil Qamili	0	77.55	8300	52,030.00	643665	4034926.5	3,391,261.50	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
67	8605	33/222ND	Emin Shehu	0	64.24	8300	52,030.00	533192	3342407.2	2,809,215.20	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
68	8605	33/430	Kastriot Lelaj	398.2	97	8300	52,030.00	3305060	5046910	8,351,970.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
69	8605	33/335/3	Nure Omeri	143.1	347.1	8300	52,030.00	1187730	16480953	17,668,683.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja, 2 kate, kati I 156.9 m², kati II 190.2 m². Mbajtur vlera e truallit për kII
70	8605	2/208/2	Lavdosh Xhaferaj	223.9	48.3	8300	52,030.00	1858370	2513049	4,371,419.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
71	8605	2/208/3	Kundret Kapaj	116.1	16	8300	52,030.00	963,630.00	832,480.00	1,796,110.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
72	8605	33/28-ND	Bajram Mustafa Guaci	-	109	8300	52,030.00		5,671,270.00	4,766,570.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
										582.407.368,82	

VENDIM
Nr. 600, datë 1.7.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 27, DATË 14.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 110 KV ERSEKË-PËRMET"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 27, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.".

b) Në listën e miratuar të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ky projekt, rreshti i fundit i tabelës, evidentuar me shtyllën nr. 192, bëhen plotësimet dhe saktësimet sipas të dhënave të përcaktuara në tabelën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

c) Në listën e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kV Ersekë-Përmet, miratuar me vendimin nr. 27, datë 14.01.2015, të Këshillit të Ministrave, shtohet lista e pasurive të paluajtshme, me sipërfaqen prej 55.89 (pesëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e nëntë) m^2, sipas të dhënave të përcaktuara në tabelën 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

ç) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelat që i bashkëlidhen këtij vendimi, për sipërfaqen 2 383,76 (dy mijë e treqind e tetëdhjetë e tre presje shtatëdhjetë e gjashtë) m^2, tokë bujqësore, pyll, arë, kullotë, truall, vlerësuar në shumën prej 364 002,88 (treqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dy presje tetëdhjetë e tetë) lekësh.".

d) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Fondi prej 364 002,88 (treqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dy presje tetëdhjetë e tetë) lekësh të përballohet nga fondet e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST).".

dh) Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

"7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Ersekë, Kolonjë, Përmet dhe Gjirokastër të marrin masat për pezullimin e të gjitha transaksioneve mbi këto pasuri deri në përfundim të procesit të kalimit të pronësisë së pasurive të shpronësuara në favor të OST sh.a.".

2. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, OST sh.a., dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA SHTESË E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 110 KV ERSEKË-PËRMET

Qarku Gjirokastër
NB Përmet

Tabela 1

Nr.	Nr. shtyllës sipas projektit	Emri	Mbiemri	Lloji pasurisë	ZK	Nr. Pasurie	Sipërfaqja e shpronësimit m²	Çmimi lekë/m²	Vlera kompensimit/lekë
5	192	Gjergji Hektor	Rusha Rusha	truall	2917	12/40	21	797	16737

Qarku Korçë
Komuna Leskovik
Fshati VREPCKE

Tabela 2

Nr.	Nr. shtyllës sipas projektit	Emri	Mbiemri	Lloji pasurisë	ZK	Nr. pasurie	Sipërfaqja e shpronësimit m²	Çmimi lekë/m²	Vlera kompensimit/lekë
1	72	Xhelal Esat Luan	Mezini	Pyll	3826		16.59	85	1410.15
2	73	Xhelal Esat Luan	Mezini	Pyll	3826		19.65	85	1670.25
3	74	Xhelal Esat Luan	Mezini	Pyll	3826		19.65	85	1670.25
	Totali						**55.89**		**4750.65**

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 336 lekë